

Pasqyrë e programit të Edukimit Fizik dhe Sportit (BA)

Programi
Bachelor - “Edukim Fizik dhe Sport” 240 ECTS 2024/2027

Viti i (I) Parë						
Sesimestri I			Orë/ javë			
No.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	Ligjëruesi
1.	O	Anatomi Funktionale	2	1	6	
2.	O	Zhvillim Motorik	2	2	6	
3.	O	Volejball	2	2	6	
4.	O	Hendboll	2	2	6	
5.	O	Pedagogji e edukimit fizik dhe sportit	2	0	5	
6.	O	Shkrim akademik	2	0	5	
7.	O	Gjuhë e huaj (Angleze)	2	0	5	
8.	O	Atletikë	2	2	6	
9.	O	Kineziologji	2	1	6	
Semestri II			Orë/javë			
1.	O	Anatomi Funktionale	2	1	-	
2.	O	Zhvillim Motorik	2	2	-	
3.	O	Volejball	2	2	-	
4.	O	Hendboll	2	2	-	
5.	O	Gjuhë e huaj (Angleze)	2	0	-	
6.	O	Atletikë	2	2	-	
7.	O	Informatikë	2	1	5	
8.	Z	Pingpong	1	1	4	
9.	Z	Fairplay në sport	2	0	4	
10.	Z	Aerobi	1	1	4	
11.	Z	Aftësitë e komunikimit dhe prezantimit	2	0	4	

Viti i (II) Dytë

Semestri III			Orë/ javë			
No.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	Ligjëruesi
1.	O	Fiziologjia e ushtrimeve dhe sportit	2	1	6	
2.	O	Gjymnastikë sportive	2	2	6	
3.	O	Psikologji e edukimit fizik dhe sportit	2	0	5	
4.	O	Basketboll	2	2	6	
5.	O	Hyrje në Biomekanikë	2	1	6	
6.	O	Noti	2	2	6	
7.	O	Rekreacion Sportiv	2	1	5	
8.	O	Sociologji e edukimit fizik dhe sportit	2	0	4	
9.	Z	Lojërat elementare	2	1	4	
10.	Z	Procesi stërvitor në Volejball	2	1	4	
11.	Z	Procesi stërvitor në Hendboll	2	1	4	
12.	Z	Menaxhimi i objekteve sportive	2	0	4	
Semestri IV			Orë/javë			
1.	O	Fiziologjinë e ushtrimeve dhe sportit	2	1	-	
2.	O	Gjymnastikë sportive	2	2	-	
3.	O	Basketboll	2	2	-	
4.	O	Hyrje në Biomekanikë	2	1	-	
5.	O	Noti	2	2	-	
6.	O	Histori e edukimit fizik dhe sportit	2	0	4	
7.	O	Shëndeti dhe aktiviteti fizik	2	0	4	
8.	Z	Procesit stërvitor në Atletikë	2	1	4	
9.	Z	Fushimi malor dhe bregdetar	2	1	4	
10.	Z	Beach Volley	2	1	4	
11.	Z	Tenis	2	1	4	

Sqarim: Numri total i kredive (ECTS) të akumuluarra për një vit është 60 ECTS – kredi. Nga 10 lëndët obligative fitohen gjithsej 56 ECTS, nga 4 lëndë zgjedhore studenti është i obliguar të zgjedhë 1 lëndë në semestrin e dytë, 4 ECTS – kredi.

Viti i (III) Tretë

Semestri V			Orë/ javë			Ligjëruesi
No.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	
1.	O	Mjekësi sportive	2	1	6	
2.	O	Futboll	2	2	6	
3.	O	Vallëzim	2	2	6	
4.	O	Gjymnastikë ritmike	2	2	6	
5.	O	Nutricioni në sport	2	0	5	
6.	O	Sportet luftarake	2	2	6	
7.	Z	Fëmijët në sport	2	1	4	
8.	Z	Akrobatikë	2	1	4	
9.	Z	Sporti dhe moshimi	2	1	4	
10.	Z	Procesi stërvitor në basketboll	2	1	4	
11.	Z	Procesi stërvitor në not	2	1	4	
Semestri VI			Orë/ javë			Ligjëruesi
No.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	
1.	O	Mjekësi sportive	2	1	-	
2.	O	Filozofia dhe etika në sport	2	0	5	
3.	O	Futboll	2	2	-	
4.	O	Vallëzim	2	2	-	
5.	O	Skijim	2	2	6	
6.	O	Sportet luftarake	2	2	-	
7.	O	Kineziterapi	2	1	6	
8.	Z	Procesi stërvitor në gjymnastikë	2	1	4	
9.	Z	Mini Basketboll	2	1	4	
10.	Z	Traumatologjia dhe ndihma e parë	2	1	4	
11.	Z	Preventiva e lëndimeve në sport	2	1	4	
12.	Z	Edukim fizik special	2	1	4	

Sqarim: Numri total i kredive (ECTS) të akumuluarra për një vit është 60 ECTS – kredi.

Nga 10 lëndët obligative fitohen gjithsej 52 ECTS, nga 8 lëndë zgjedhore studenti është i obliguar t'i zgjedhë 2 lëndë zgjedhore, 8 ECTS – kredi. Përkatësisht një lëndë në semestrin e parë dhe një në të dytin.

TOTALI: 60 ECTS

Viti i (IV) Katërt

Semestri VII			Orë/ javë			Ligjëruesi
No.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	
1.	O	Didaktikë e edukimit fizik	2	2	6	
2.	O	Teoria dhe metodologjia e stervitjes sportive	2	1	6	
3.	O	Përgatitja fizike e sportistëve	2	1	5	
4.	O	Matjet dhe testimet në sport	2	1	5	
5.	O	Fitnes	2	2	5	
6.	O	Bazat e planifikimit të mësimdhënies në shëndet dhe mirëqenie	2	1	5	
7.	Z	Aktivitete në ujë dhe siguria	2	1	4	
8.	Z	Procesi stërvitor në Vallëzim dhe Gjinnastikë ritmike	2	1	4	
9.	Z	Sporti për zhvillim	2	1	4	
10.	Z	Procesi stërvitor në futboll	2	1	4	
11.	Z	Procesi stërvitor në sportet luftarake	2	1	4	
Semestri VIII			Orë/ javë			Ligjëruesi
No.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	
1.	O	Didaktikë e edukimit fizik	2	1	-	
2.	O	Teoria dhe metodologjia e stervitjes sportive	2	1	-	
3.	O	Fitnes	2	2	-	
4.	O	Bazat e planifikimit të mësimdhënies në shëndet dhe mirëqenie	2	1	-	
5.	O	Statistika dhe metodat kërkimore	2	2	5	
6.	O	Matjet dhe testimet në sport	2	1	-	
7.	Z	Menaxhimi dhe marketingu në sport	2	1	4	
8.	Z	Sporti inkluziv	2	1	4	
9.	Z	Futsall	2	1	4	
10.	Z	Kursi i avansuar i skijimit	2	1	4	
11.	O	Tema e diplomës			15	

Sqarim: Numri total i kredive (ECTS) të akumuluarra për një vit është 60 ECTS – kredi.

Nga 9 lëndët obligative fitohen gjithsej 52 ECTS, nga 10 lëndë zgjedhore studenti është i obliguar t'i zgjedhë 2 lëndë zgjedhore, 8 ECTS – kredi. Përkatësisht një lëndë në semestrin e parë dhe një në të dytin.

TOTALI: 60 ECTS

SYLLABUSET

VITI I SEMESTRI I

Lënda: Anatomi funksionale				
Viti I	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester I-II	Obligative	2	1	6
<u>Përmbajtja:</u> Eshtë lënda më e rëndësishme dhe më themelorja për studentët që studiojnë në këtë lëmi dhe mund të themi se është bazë për njohuri të mëtejme të studimeve. Pra është fundamentale për të pasur njohuri për studimin e eshtrave (skeletin), muskulaturën, nyjëtimet, organet etj.				
<u>Oëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Ofron njohuri nga: a)Anatomia normale (forma dhe ndërtimi i organizmit të njeriut) b)Anatomia topografike e trupit të njeriut;ndarja e tij në regjione,raporte topografike me organet dhe elementet vaskulare,nervore,projektimin e tyre në sipërfaqen e trupit. c)Anatomia funksionale;ndërlidhja e formës së organit dhe sistemit te organeve me funksionin. d)Të përvehtësoj emërtimet latine sipas terminologjisë anatomike (nomenklatura anatomike 1998). (nënkuptomë njohuritë,aftësitë dhe shkathtësitë që do ti fiton studenti pas përfundimi të suksesshëm të këtij kursi.Për ti paraqitur këto të arritura,përdoren foljet si: din,nje,përshkruan,krahason,projekton,harton,zhvillon,etj)				
<u>Metodat e mesimdhënies dhe mesimnxënies:</u> Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.				
<u>Literatura:</u> Behnke R.S. Kinetic Anatomy. 3-rd edition. Human kinetics, Champign (2012) Delavier F. Strength Training Anatomy, 3-rd edition,Human Kinetics, Champign (2010)				
<u>Forma e vleresimit:</u> <i>Vlerësimi ne pikë(%):Pjesmarrja në ligjërata 10 pikë, Prezantime seminarike 20 pikë, Testime të ndryshme me shkrim 5 pikë, Punime të ndryshme krijuese (grupore) 15 pikë, Provimi me shkrim 50 pikë</i>				

Lënda: Zhvillimi Motorik				
Viti I	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester I-II	Obligative	2	2	6
<u>Përmbajtja:</u> Zhvillimi motorik në funksion të transformimit të statusit antropologjik e në veçanti zhvillimit të aftësive lëvizore				
<u>Qëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Informatat themelore të moduleve të parapara teorike dhe praktike, analiza konceptet themelore të lëvizjeve, llojet e lëvizjeve. Termonologjia e lëvizjeve trupore. Lëvizjet në funksion të transformimit dhe zhvillimit të aftësive motorike të njeriut. Lëvizjet elementare dhe ato të formimit në funksion të zhvillimit motorik. Rëndësia e lëvizjeve dhe roli i tyre në sistemin lokomotor, formimin e trupit, eliminimin e masës së tepërt trupore etj. Aftësitë lëvizore, lëvizjet për force, shpejtësi, koordinim, fleksibilitet, qëndrueshmëri etj. Të aplikojnë lëvizjet nga më të ndryshmet për realizimin e qëllimeve të sipërshënuara. Ti shfrytëzojnë stimulatorët kineziologjik lëvizorë në zhvillimin truporë. Të projektojnë modele të caktuara programore, varësisht nga qëllimi, kërkesat moshë, gjinia etj. Të ju mundësoj studentëve zotërimin me sukses/më me lehtësi/ të përmbajtjeve programore të kurseve tjera.				
<u>Metodat e mesimdhënie dhe mesimnxënies:</u> Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.				
<u>Literatura:</u> M. Aliu: Biomotorika, U.P., FKF, Prishtinë, 1997 H. Rushiti: Zhvillim motorik /material i prezentuar në igjërata/ 2024. FEFS, Prishtinë, 2024 E. Dashi: Teoria e lëvizjeve, Tiranë, 2001 Rushiti. H: Relacionet ndërmjet faktorit gjeneral të forcës dhe mekanizmit të rregullimit strukturorë të lëvizjeve (disertacion i doktoraturës).				
<u>Forma e vlerësimit:</u> Seminare 20%; vijim 10%; Pjesëmarrje aktive 10%; provimi teorik 25% Provimi praktik 35%. <u>Vlerësimi pozitiv fitohet me grumbullim kumulativ të pikëve (përqindjeve) ku minimum i nevojshëm është 51% i pikëve.</u>				

Lënda: Volejboll				
Viti I	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester I/II	Obligative	2	2	6
<u>Përmbajtja:</u> Detyrat eLendes jane: Njohuri ne Metodiken e te mesuarit ne lenden e Volejbollit per studente, njohuri ne aspektin profesional dhe shkencor, informata per Volejbollin ne aktivitetet e jashtme, garat shkollore, aktivitetete rekreative etj.				
<u>Oëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Perfitimi I bazave didaktiko metodike ne aftesimin e elementeve tekniko taktike per nxenes ne shkolla fillore dhe te mesme. Edukim I arsimtareve te ardhshem te edukimit fizik per organizimin e seksioneve te Volejbollit, garave shkollore dhe ndershkollore, njohja me vlerat dhe ndikimine volejbollitne statusin antropologjikte nxenesve, studenteve dhe njerzve qe merren me rekreacion. Studentet qe me sukses plotesojne te gjitha detyrat e ketij moduli aftesohen qe te ardhmen te mesojne nxenesit ne; lojen e volejbollit, organizimin e garave shkollore, garave rekreative, njohjene rregullave te lojes, sistemeve te lojes etj.				
<u>Metodat e mesimdhenies dhe mesimnxenies:</u> Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.				
<u>Literatura:</u> 1. Musa Selimi, Bahri Gjinovci, Enver Gjinolli (2014). Volejbollit – Metodologjia e te mesuarit. Digiprint. 2. www.fivb.org ; www.cev.org				
<u>Forma e vleresimit:</u> <u>Seminare 20%; vijim 10%; Pjesëmarrje aktive 10%; provimi teorik 25% Provimi praktik 35%.</u> <u>Vlerësimi pozitiv fitohet me grumbullim kumulativ te pikëve (perqindjeve) ku minimum i nevojshëm është 51% i pikëve.</u>				

Lënda: Hendboll				
Viti I	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester I/II	Obligative	2	2	6
<p><u>Përmbajtja:</u> Të arrihet aftësimi i studentëve si dhe proceset permanente e përvetësimi i tyre profesional e kërkimor, duke u bazuar në hendbollin më bashkëkohor në punën për paisjen dhe avancimin e studentëve. Studentët do të marrin njohuri themelore të përgjithshme, e të hartojnë planprograme bazike më relevante për hendbollin bashkëkohorë. Zhvillojnë aftësitë e tyre me format organizative të punës, dijnë t'i zgjedhin mjetet, metodat, dhe ngarkesat, të cilat paraqiten gjatë seancave stërvitore, sidomos ata të cilët orientohen në lëndën e hendbollit.</p>				
<p><u>Oëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Është që studentët të jenë në gjendje që tëtë: të marrin informata mbi të arriturat më të reja teori praktike, si bazë e planifikimit, kontrollimit të proceseve stërvitore në kuadër të lëmisë së hendbollit. Nënkuptojnë njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë, që do t'i fiton studenti pas përfundimit të suksesshëm të ligjëratave teorike e praktike.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohuritë metodike të elementeve tekniko- taktike - Të hartojë dhe planifikojë materien e lëndës së hendbollit. - Të udhëheqë dhe zhvillojë procesin e mësimin nga lënda e hendbollit. - Të vlerësojë nivelin e të arriturave gjatë procesit të transformimit - Të planifikojë dhe programojë punën praktike profesionale - Të demonstrojë të gjitha elementet teknike të hendbollit. - Të kenë njohuri përkatëse për rregullat mbi organizimin e seancave stërvitore dhe garave të niveleve të ndryshme. - Të jenë në gjendje të studiojnë literaturën 				
<p><u>Metodat e mesimdhënies dhe mesimnxënies:</u> Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.</p>				
<p><u>Literatura:</u> Çitaku.F."Stërvitja sportive në hendboll" – Tekst Mësimor Univeuniversitar – 2009. Prishtinë G.Kavaja.:J. Jarani; Hendboll (rregullat bazë). Tiranë-2004. Zyber. K."Hendboll për mësuesit dhe treneret e hendbollit Arthur D. Hando (2021). Handball Playbook: Practical Handball Game Coach Play Book. Zyber. K."Hendboll për mësuesit dhe treneret e hendbollit K. Atk- Vuleta, D., Milanović, D. i sur. (2004). Znanstvena istraživanja u rukometu. Zagreb - Gruić, I., Vuleta, D. (2008). Comparison of physical conditioning status of first and the male handball second league players. - Carol Demand: HANDBALL 101, 2023.</p>				
<p>Pjesëmarrja dhe angazhimi në mësim: 10% Puna praktike dhe seminarët 20 % Testet intermediere (semestrare dhe gjysmësemestrare) 30% Provimi final teorik dhe praktik 40% Rezultatet e vlerësimit përfundimtar 100%</p>				

Lënda: Pedagogji e edukimit fizik dhe sportit				
Viti I	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester I	Obligative	2	0	5
<u>Përmbajtja:</u>				
Pasqyre e njohjes se pedagogjise se sportit nga konteksti kulturor dhe social, disiplinat, parimet, faktoret, permbajtjet edukativo-arsimore, format dhe tipet e trajningut, psiko-pedagogjia si dhe metodat dhe detyrat e shkences se pedagogjise.				
<u>Oëllimet dhe rezultatet e pritura:</u>				
Objektivi kryesor I kesaj lende eshte I orientuar kryesisht ne zhvillimin e pedagogjise se sportit neper etapa te ndryshme te educates se njerzimit. Kuptimi I kontekstit kulturor dhe social te pedagogjise, disiplinat e pedagogjise, parimet edukativo arsimor, format dhe tippet e trajningut mendor-mental.etj Pasi studenti ta perfundoj kete kurs (lende) ai duhet te jet ne gjendje ta njohe kuptimin dhe karakterin e shkences se pedagogjise, edukaten ne kuptimin e gjere dhe te ngushte, sistemin e shkences se pedagogjise, raportin e pedagogjise ndaj shkencave tjera, deri te shkolla, mesuesi-nxenesi mardhenjet e tyre.				
<u>Metodat e mesimdhenies dhe mesimnxenies:</u>				
Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.				
<u>Literatura:</u>				
<ol style="list-style-type: none"> 1. Bronikowski et al (perkthim ne shqip – 2014). Pedagogjia e Sportit – didaktika dhe shkencat mesimore. Night design studio. 2. Ligjerate e autorizuar – Pedagogjia e sportit. 				
<u>Forma e vleresimit:</u>				
<i>Vlerësimi ne pikë(%):Pjesmarrja në ligjërata 10 pikë, Prezantime seminarike 20 pikë, Testime të ndryshme me shkrim 5 pikë, Punime të ndryshme krijuese (grupore) 15 pikë, Provimi me shkrim 50 pikë</i>				

Lënda: Shkrim akademik				
Viti I	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester I	Obligative	2	0	5
<p><u>Përmbajtja:</u> Lënda do të përfshijë mësimin dhe praktikën e të shkruarit: do të përfshijë edhe shkrimin dhe leximin e punimeve me shkrim gjatë orëve mësimore. Studentët do të nxiten t'i publikojnë shkrimet e tyre profesionale në media të shkruara, me qëllim të përplotësimit të kërkesave themelore të lëndës, përkatësisht përplotësimit të realizimit praktik të mënyrës së shkrimit.</p>				
<p><u>Qëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Qëllimi kryesor i lëndës Shkrim akademik është njohja e studentëve me kulturën e shkrimit, në aspektin drejtshkrimor, si dhe njohja me nocionet thelbësore të të shkruarit intelektual – akademik.</p> <ul style="list-style-type: none"> > të shprehin dhe demonstrojnë aftësitë e leximit dhe interpretimit kritik; > të demonstrojnë shkathtë në procesin e të shkruarit: gjenerimi i ideve, përgatitje e drafteve, rishikimi, editimi dhe prezantimi; > të shkruajnë drejt dhe sipas normave të kodifikuara fjalët dhe trajtat e ndryshme të tyre; > të aftësohen t'i vërejnë gabimet drejtshkrimore në tekste; 				
<p><u>Metodat e mesimdhenies dhe mesimnxenies:</u> Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.</p>				
<p><u>Literatura:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, “Rilindja”, Prishtinë, 1975 2. Eko, Umberto, Si të bëhet një punim diplome, “Dituria”, Tiranë, 1997. 				
<p><u>Forma e vlerësimit:</u> <i>Vlerësimi ne pikë(%):Pjesmarrja në ligjërata 10 pikë, Prezantime seminarike 20 pikë, Testime të ndryshme me shkrim 5 pikë, Punime të ndryshme krijuese (grupore) 15 pikë, Provimi me shkrim 50 pikë</i></p>				

Lënda: Gjuhe e huaj (Angleze)

Viti I	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester I/II	Obligative	2	0	5

Përshkrimi i lëndës: Kursi *Gjuhë Angleze* në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit ndërtohet mbi komponentin e anglishtes për qëllime të veçanta, i cili mëton që studentin ta përfushojë ndaj terminologjisë sportive, përfshirë secilin sport në përgjithësi, si atë të lojërave olimprike verore dhe dimërore, sporteve luftarake, sporteve ujore, dhe futbollit në veçanti, dhe për rrjedhojë përdorimin praktik të vokabularit sportiv. Më tej, kursi në fjalë ka për fokus kryesisht zhvillimin e dy shkathtësive gjuhësore: shkathtësisë së të shkruarit – ku studenti do të jetë në gjendje të shkruajë emaile formale dhe jo-formale, resume, letra motivuese, dhe shkathtësisë së të folurit, ku studenti do të jetë në gjendje të flasë rrjedhshëm në një nivel më të avancuar në ambiente të ndryshme.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura:

- Kursi synon maksimizimin e performancës individuale e kolektive të studentëve, frymëzimin e interesit të tyre për mësimnxënie dhe brendësimin e një ndjenje të vetëbesimit te secili student. Kursi është paraparë që ta përgatisë studentin për shfrytëzimin e mëvonshëm të gjuhës angleze në veprimtaritë e tij profesionale dhe në punimet kërkimore shkencore. Përmes kursit në fjalë, synohet që studentit t'i ofrohet mundësia e përvetësimit të një anglishteje më të avancuar, duke e bartur atë në një nivel të mjaftueshëm për nivelet akademike. Kjo ia mundëson atij shfrytëzimin e literaturës në këtë gjuhë dhe kumtimin në konferenca të ndryshme ndërkombëtare dhe në diskutime të tjera profesionale në të ardhmen.
- Në përfundimin e këtij kursi, studenti i vlerësuar pozitivisht do të jetë në gjendje:
 - - të zotërojë vokabularin sportiv;
 - - të flas në mënyrë korrekte, rrjedhshëm dhe të avancojë në drejtshkrim;
 - - të arrijë të komunikojë për nevojat e veta në një ambient ku flitet gjuha angleze;
 - - të përdorë gjuhën angleze në një nivel më të avancuar për nevoja akademike;
 - - të përdorë gjuhën angleze në kontekste të ndryshme përdorimi;
 - - të jetë në gjendje të shkruaj emaile, kërkesa, letra motivuese, etj. në gjuhën angleze;
 - - të njihet me shtresimet më komplekse të anglishtes.

Metodat e mesimdhenies dhe mesimnxenies:

Vlerësimi mbështetet në këto aktivitete:

- Pjesëmarrja në klasë: **20%**
- Participim aktiv në klasë: **10%**
- Testi I: **30%**
- Prezantimi i punimit seminarik: **10%**
- Testi II: **30%**
- Totali: **100%**

Pikët (%) / Nota përfundimtare

92-100	10
81-91	9
70-80	8
60-69	7
50-59	6

Literatura:

- Redmond, A. & Warren, S. (2012). *English for Football*, Oxford University Press, United Kingdom.
- Kay, S. & Jones, V. *New Inside Out Sport*, Macmillan Education.
- Different materials downloaded from different internet sources.

Forma e vlerësimit:

Vlerësimi në pikë(%): Pjesëmarrja në ligjërata 10 pikë, Prezantime seminarike 20 pikë, Testime të ndryshme me shkrim 5 pikë, Punime të ndryshme krijuese (grupore) 15 pikë, Provimi me shkrim 50pikë

Lënda: Atletikë				
Viti I	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester I/II	Obligative	2	2	6
<p><u>Përmbajtja:</u> Përmbledhja e lëndës do të zhvillohet në aspektin praktik dhe teorik. Njohja me prejardhjen historike të sportit të atletikës dhe vlerat e saj si mjet kryesor i edukimit fizik. - Njohja me bazat teorike dhe praktike në llojet kryesore atletikore. - Njohja e skenave teknike dhe praktike në llojet atletikore. - Te ushtruarit në llojet atletikore gjatë procesit arsimor, duke synuar në rritjen e aftësive fizike e demonstruese të skenave teknike.</p>				
<p><u>Oëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Paisja e studentëve me njohuri bazë mbi atletikën, si sport me vlera të mëdha jetësore, si mjet i edukimit fizik për formimin e shprehive metodike aplikative, mbi organizimin dhe demonstrimin e skenave teknike atletikore sipas programit.</p>				
<p><u>Metodat e mesimdhënies dhe mesimnxënies:</u> Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.</p>				
<p><u>Literatura:</u> Atletika “ Dispenc “ Prishtinë, 2006 N.Rashti, Broshura “Vrapimet e Sprintet” Tiranë. Bernans, E., & Saulgriezis, R. (2023). <i>The Effect of Velocity on Flight Phase Duration in Race Walking</i>. Peev, P., & Hristov, O. (2023). <i>Optimization of Race Walking Methods Through Preparatory Exercises</i>. ALTIS. (2019). <i>Coaching the Short Sprints</i>. SHBA. – (2013). <i>Sprinting: Training, Techniques and Improving Performance</i>. Mbretëria e Bashkuar. (2025). <i>Study on the Evaluation and Training Strategies of Middle-Distance Running</i>.</p>				
<p><u>Forma e vlerësimit:</u> Vlerësimi i lëndës do të zhvillohet në aspektin praktik dhe teorik. Vlerësimi i studentit do të bëhet mbi bazën e demonstrimit të saktë të teknikës, që është zhvilluar gjatë vitit. Ecje sportive skema teknike Starti dhe vrulli i startit dhe vrapimi në distancë (<i>teknike</i>) Vrapimet stafetore(<i>teknike</i>), Vrapimi me pengesa(<i>teknike</i>) Kërcimi së gjati me trup në hark, (<i>teknike</i>), Kërcimi së gjati me hapa në ajër(<i>teknike</i>) Kërcimi trehapësh (<i>teknike</i>), Kërcimi së larti “Barkush”(<i>teknike</i>) Kërcimi së larti “Shpinazi”(<i>teknike</i>), Kërcimi së larti me purtek (për shkak të kushteve teknike nuk ekzekutohet), Shtytja e gjylës” shpinazi ”, Hedhja e shtizës(<i>teknike</i>), Hedhja e diskut (<i>teknike</i>) Hedhja e çekanit (për shkak të kushteve teknike nuk ekzekutohet)</p> <p>Shënime: Studenti vlerësohet kalueshëm kur shlyen pozitivisht të gjitha të teknikat ,5-garshin: 1800 pikë =6, 2000 pikë =7, 2200 pikë=8, 2400 pikë=9 dhe 2600 pikë= 10, dhe teorinë e atletikës sipas planprogramit.</p> <p>Seminare 20%; vijim 10%; Pjesëmarrje aktive 10%; provimi teorik 25% Provimi praktik 35%. Vlerësimi pozitiv fitohet me grumbullim kumulativ të pikëve (perqindjeve) ku minimum i nevojshëm është 51% i pikëve.</p>				

Lënda: Kineziologji				
Viti I	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester I	Obligative	2	1	6
<p><u>Përmbajtja:</u> Kineziologjia është shkencë shumëdisiplinore aplikative hulumton dhe udhëheq aktivitetet fizike të orientuara në drejtim të ngritjes dhe avansimit të shëndetit. Kineziologjia pra, është shkencë mbi aktivitetet e veçanta të kushtëzuara qëllimi i së cilës është vërtetimi i ligjshmërive të proceseve transformuese të dimensioneve psikosomatike nën ndikimin e atyre lëvizjeve. Lënda e kineziologjisë përfshinë: nocionin dhe zhvillimin e saj nëpër faza kohore, strukturën dhe diciplinat e kineziologjisë, aspektin antropologjik, detyrat dhe parimet, metodat e kineziologjisë, lidhjen e kibernetikes me kineziologjinë, përshkrimin e sistemeve dhe ligjshmëritë e transformimit.</p>				
<p><u>Qëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Qëllimi i kineziologjisë është prezantimi i njohurive mbi studimin e ligjshmërive të përgjithshme të lëvizjes së njeriut, ligjshmërive të përgjithshme të udhëheqjes me procesin stërvitor si dhe pasojat e ndikimit direkt dhe indirekt të këtyre proceseve në organizmin e sportistit dhe njerzve me përgatitjetë ndryshme kondicionale. Një ndër qëllimet e veçanta është hulumtimi dhe njoftimi me kushtet historiko-shoqërore në të cilat është lajmruar kineziologjia dhe formohet si lëmi e mvetësishme hulumtuese dhe shkencore. Detyra e kësaj lëmie është të njoftohen studentët me rezultatet themelore dhe metodologjinë e hulumtimit në lëminë e kineziologjisë, mënyrën e përcaktimit e të gjitha parametrave relevant të modelit të përgjithshëm të procesit transformues kineziologjik, pastaj me ndryshimet e mundshme të karakteristikave antropologjike, njohurive motorike dhe shëndetit dhe efekteve tjera nën ndikimin e udhëhequr të procesit së të ushtruarit me programe të caktuara të ushtrimeve. Pas përfundimit të ligjeratave ose nga lënda e kineziologjisë studentët do të aftësohen dhe do të jenë në gjendje që: Të njohin dhe krahasojnë zhvillimin e drejt psikosomatik si tek nxënësit ashtu edhe tek sportistët që i nënshtrohen tretmanit stërvitor. Të dallojnë parimet themelore të një jete të shëndosh në përmbushjen e nevojave biopsikosociale për lëvizje të drejta, për mënyrën e kohës së lirë si dhe përcjelljen dhe jenë në gjendje të vërtetojnë ndikimin e tretmaneve kineziologjike nëpër periudha kohore ose tranzitore si dhe njoftimi me pasojat e këtyre tretmaneve stërvitore.</p>				
<p><u>Metodat e mesimdhënies dhe mesimnxënies:</u> Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.</p>				
<p><u>Literatura:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Hoffman J. S., and Harris, C. J. (2000). Introduction to kinesiology. Champaign, IL: Human Kinetics Publishers, Inc. Findak, V., D. Metikoš, M. Mraković, B. Neljak (1996). Primijenjena kineziologija u školstvu - NORME. Hrvatski pedagoško-književni zbor, Zagreb. Mraković M. (1993.) Osnove sistematske kineziologije. Priručnik za sportske trenere. Fakultet za fizičku kulturu Sveučilišta u Zagrebu. 19-61. 				
<p><u>Forma e vlerësimit:</u> <i>Vlerësimi ne pikë(%):Pjesmarrja në ligjërata 10 pikë, Prezantime seminarike 20 pikë, Testime të ndryshme me shkrim 5 pikë, Punime të ndryshme krijuese (grupore) 15 pikë, Provimi me shkrim 50 pikë</i></p>				

VITI I PARË - SEMESTRI II

Lënda: Informatike				
Viti I	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester II	Zgjedhore	2	1	5
<u>Përmbajtja:</u> Kjo lëndë do të përmban temat themelore mbi shkencat kompjuterike dhe temat nga përdorimi i veglave të MS Office-it.				
<u>Qëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Ky modul do të ndihmoj në ngritjen e shkathtësive të studentëve për përdorimin e veglave të MS Office-it në plotësimin e nevojave të tyre për të kryer punët e zyrës dhe për të zgjidhur problem të ndryshme në leminë e kultures fizike, të analizave të ndryshme të të dhënave si dhe llogaritjes së rezultateve të ndryshme në metodologjinë hulumtuese dhe të dhënave të ndryshme statistikore. Njohuri dhe shkathtësi të mjaftueshme në përdorimin e veglave të MS Office sic janë: – MS Word; - MS Excel; - MS Access; - MS Project dhe - MS Power Point sidhepërdorimmëtëpërparuartë - Internetidhe MS Outlook-ut.				
<u>Metodat e mesimdhënies dhe mesimnxënies:</u> Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.				
<u>Literatura:</u> 1. Dr.sc.Vehbi Rama, Msc.Helidon Kastrati; Bazat e Informatikës, Prishtinë, Nëntor, 2012.				
<u>Forma e vlerësimit:</u> <i>Vlerësimi në pikë(%):Pjesmarrja në ligjërata 10 pikë, Prezantime seminarike 20 pikë, Testime të ndryshme me shkrim 5 pikë, Punime të ndryshme krijuese (grupore) 15 pikë, Provimi me shkrim 50 pikë</i>				

<u>Lënda: Pingpong</u>				
Viti I	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS 3
Semester II	Zgjedhore	1	1	4
<u>Përmbajtja:</u>				
<ul style="list-style-type: none"> ✓ Pingpongu, rëndësia dhe karakteriatikat e lojës ✓ Elementet kryesore teknike të lojës ✓ Elementet kryesore te taktikës së lojës. 				
<u>Oëllimet dhe rezultatet e pritura:</u>				
<p>Të përvetësoj informatat elementare lëvizore të lojes së Pingpong-ut.</p> <p>Të pavarësohet për mësimdhënie dhe udhëheqje në Pingpong</p> <p>Të përshkruaj dhe sqaroi problematikat që lidhet me lojen Pingpong-un</p> <p>Të hartoi dhe projektoi Ide në lidhje me organizimin e ndonjë aktiviteti në Pingpong</p> <p>Njohja me rregullat e garave.</p> <p>Përmbajtjet programore të kursit të ju mundësoj studentëve aplikimin praktik të informatave dhe njohurive të kësaj lëmie me kategori të ndryshme si ato për të rinjtë e deri te sendorët.</p> <p>Të aplikoj në formë rekreative dhe garuese teknikat kryesore të lojës.</p> <p>Shfrytëzimit të mjeteve dhe metodave didaktiko metodike të mesuarit të elementeve bazë të lojës.</p> <p>Të kenë njohuri përkatëse për aplikimin e rregullave, organizimit të garave etj.</p>				
<u>Metodat e mesimdhënies dhe mesimnxënies:</u>				
Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.				
<u>Literatura:</u>				
<ol style="list-style-type: none"> 1. Bahtiri. Të mesojmë të luajm Pingpong. Prishtinë 2006 2. Lary Hodges. Table Tennis Step to sukses, United States Tennis Assosiation 				
<u>Forma e vleresimit:</u>				
<u>Seminare 20%; vijim 10%; Pjesëmarrje aktive 10%; provimi teorik 25% Provimi praktik 35%.</u> <u>Vlerësimi pozitiv fitohet me grumbullim kumulativ te pikëve (perqindjeve) ku minimum i nevojshëm është 51% i pikëve.</u>				

Lënda: Fairplay ne sport				
Viti I	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester II	Zgjedhore	2	0	4
<p><u>Përmbajtja:</u> Lënda Fair Play në Sport fokusohet në vlerat themelore të ndershmërisë, respektit dhe integritetit, të cilat janë thelbësore jo vetëm për sportin, por edhe për jetën e përditshme.</p> <p>Ajo synon të zhvillojë te studentët kuptimin e drejtë të parimeve të fair play-t dhe rëndësinë e tyre në formimin personal dhe profesional.</p> <p>Përmes analizës teorike dhe shembujve praktikë, studentët njihen me korrektësinë e lojërave sportive dhe me rolin e edukatorit në promovimin e sjelljeve etike.</p> <p>Lënda inkurajon aplikimin e koncepteve të fair play-t në procesin mësimor, në institucionet shkollore dhe jashtë tyre. Në këtë mënyrë, studentët përgatiten të kontribuojnë në ndërtimin e një kulture sportive të bazuar në respekt, barazi dhe përgjegjësi shoqërore.</p>				
<p><u>Qëllimet dhe rezultatet e pritura:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> -Qëllimi i lëndës është të aftësojë studentët për të kuptuar, interpretuar dhe zbatuar në mënyrë profesionale parimet e ndershmërisë, respektit dhe korrektësisë, si bazë e edukimit sportiv dhe e sjelljes etike në jetën e përditshme. -Lënda synon të zhvillojë tek studentët kompetenca për të analizuar dhe promovuar rregullat e fair play-t, duke i ndihmuar ata të kuptojnë se pa drejtësi, besim dhe respekt humbet kuptimi i garës dhe dëmtohet integriteti i sportit. -Përmes diskutimeve, analizave dhe rasteve praktike, studentët aftësohen të identifikojnë dhe të menaxhojnë sjelljet joetike, duke promovuar vlera të ndershme në çdo mjedis sportiv. -Në thelb, qëllimi i lëndës është të nxisë ndërgjegjësimin për rolin e sportit si mjet edukativ, moral dhe social që bashkon njerëzit dhe forcon kulturën e respektit, solidaritetit dhe përgjegjësisë. <p>Studentet aftësohen që të ardhmen të mesojnë së si t'i aplikojnë vlerat si: Respekti, Miqësia, Shpirti ekipor, Garimi korrekt dhe Sporti pa doping si dhe vlerat e shkrura dhe të pashkrura të barazisë, integritetit, solidaritetit, tolerances, kujdesit etj</p>				
<p><u>Metodat e mesimdhënies dhe mesimnxënies:</u> Metoda verbale, e demonstrimit , interactive</p>				
<p><u>Literatura:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fair Play në Sport , B.Ginovci 2. Fair Pplay The Ethics of Sport. R. L. Simon C. R. Torres, P F. Hager 3. Teaching Ethics with Sports: Recent Developments Teaching Ethics with Sports: Recent Developments. Adam Epstein, Barbara Osborne 4. International sporting events & human rights, © Jeff Mangione 				
<p><u>Forma e vleresimit:</u> Pjesëmarrja në ligjërata – 5%, testi i parë 30%, prezantimet- 15%, vlerësimi final teorik dhe praktik 50%</p>				

Lënda: Aerobi				
Viti I	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS 3
Semester II	Zgjedhore	1	1	4
<p><u>Përmbajtja:</u> Njohuritë themelore teorike dhe praktike lidhur me programet e aerobisë grupore dhe individuale. Kjo lëndë ka për qëllim që të pasurojë aftësitë dhe njohuritë dhe gamën e aktiviteteve për studentët, në mënyrë që ata të kenë mundësi të shtuara për angazhim dhe punë në të ardhmen.</p>				
<p><u>Qëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Aplikimi i programeve bazë të aerobisë grupore me kategori të moshave të ndryshme, si nevojë e punës në arsim, rekreacion dhe sport. Pas përfundimit të kursit studentët do të jenë në gjendje të: - Kuptojnë rëndësinë e aerobisë si aktivitet për trupin dhe shëndetin - Të kuptojnë format lëvizore të aerobisë - Të dallojnë intensitetin e lëvizjeve për përshtatje më të mirë në bazë të aftësive individuale</p>				
<p><u>Metodat e mesimdhënis dhe mesimnxënies:</u> Ligjerata, ushtrime, punë individuale, detyra, kolokfiume, punë grupore etj.</p>				
<p><u>Literatura:</u> - AEROBIC INSTRUCTOR MANUAL (1997). American Council of Exercise, Ur: R.T. Cotton, R.L. Goldstein. - Anderson, B. (1997). Stretching. Gopal Zagreb. - Blažević, J., Blažević, M., Zenić, N. (2011) Fitnes i aerobika (OKT2)-priručnik KIFST</p>				
<p><u>Forma e vlerësimit:</u> Seminare 20%; vijim 10%; Pjesëmarrje aktive 10%; provimi teorik 25% Provimi praktik 35%. Vlerësimi pozitiv fitohet me grumbullim kumulativ të pikëve (përqindjeve) ku minimum i nevojshëm është 51% i pikëve.</p>				

Lënda: Aftësitë e komunikimit dhe prezantimit				
Viti I	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester II	Zgjedhore	2	0	4
<p><u>Përmbajtja:</u> Kjo lëndës synon të eksplorojë elementet kryesore të aftësive komunikuese, të intervistave dhe të prezantimit. Komunikimi unik njerëzor, gjuhën njerëzore dhe perceptimin e vetvetes. Për më tepër ka të bëjë me komunikimin ndërpersonal, komunikimin në grup dhe komunikimin publik pa injoruar disa elemente të të folurit publik, që është, të folurit informativ dhe bindës si dhe praktikën intervistuese. Për t'a bërë mësimin më tepër praktik, kjo lëndë përfshin çështje të ndryshme lidhur me komunikimin teknik dhe të biznesit siç është komunikimi në vendin e punës si dhe elemente të ndryshme të procesit të kërkimit duke u fokusuar në dokumente specifike dhe aplikime të larmishme gjetiu nëpër institucione të ndryshme.</p> <p>Qëllimet kryesore të lëndës përfshijnë, por nuk janë të limituara, një kuptim të përgjithshëm të komunikimit të njeriut si shkencë dhe një zgjidhje të ndërveprimeve kompetente si në vendin e punës ashtu dhe në të folurin publik. Si i tillë, në fund të kursit studentët priten të jenë kompetentë të lartë si në komunikimin verbal dhe atë joverbal.</p>				
<p><u>Qëllimet dhe rezultatet e pritura:</u></p> <p>Qëllimi kryesor i lëndës është që të aftësojë studentët në mënyrë teorike dhe praktike për zhvillimin e procesit mësimor për lëndën në fjalë. Për këtë qëllim lënda parashtron këto kompetenca: Studentët të aftësohen, të fitojnë dituri teorike dhe praktike në komunikim intervista të ndryshme dhe prezantime nëpër shkollat fillore dhe të mesme si dhe nëpër institucione të ndryshme mediale, televizive, në radio, gazeta ditore, javore sportive etj..</p> <p>Studentët do të përmirësojnë të kuptuarit e të gjitha fushave dhe komunikimit shkencor të cilat mësuesve apo shkencëtarëve të sportit iu nevojiten për promovimin e karrieres akademike të tyre. Në veçanti ata do t'i përmirësojnë aftësitë e tyre për komunikim në klase dhe në fushën e sportit dhe do të hasin përmirësim të aftësive dhe kompetencës për të zhvilluar dhe prezantuar lëndët mësimore të tyre dhe prezantimet në mënyrë dinamike dhe motivuese.</p>				
<p><u>Metodat e mesimdhënies dhe mesimnxënies:</u></p> <p>Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.</p>				
<p><u>Literatura:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Simonds CJ, Cooper PJ. Communication for Classroom Teachers. (9th ed.) Allyn & Bacon 2010 2. McCarthy P, Hatcher C. Presentation Skills. The Essential Guide for Students. Sage Pub. 2002 3. Finkelstein E, Samsonov P. Power Point for Teachers. Dynamic Presentations and Interactive Classroom Projects. John Wilkey & Sons 2008 4. Grout H, Long G. Improving Teaching and Learning in Physical Education. Mc Graw Hill 2009 5. D.Shehu; Strategjitë në komunikim, intervista dhe prezantime. 2015. Tiranë. 6. H. Lawrence. Johnston, L. Carpenter, L. Assistive technology access for all students. New Jersey. 2007. 7. Musai; Bardhyl, Godole Tidita, Abdurrahmani Jonila. Edukimi Mediatik. Tiranë. 2011. 8. Osmani, F. Teknikat dhe teknologjitë mësimore. Tetovë. 2008. 9. Projekt E-Shkollo. Doracak për përdorim inovativ të teknologjisë në shkollat fillore. Shkup. 2006. 10. Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë, 2007-2017. 11. Sivakova, D. Ndikimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në përmirësimin e mësimin, Bitola, 2007. 12. Varosanec,S. Zbatimi i kompjuterit në mësim. Zagreb, 2017. 				
<p><u>Forma e vlerësimit:</u></p> <p><i>Vlerësimi ne pikë(%):Pjesmarrja në ligjërata 10 pikë, Prezantime seminarike 20 pikë, Testime të ndryshme me shkrim 5 pikë, Punime të ndryshme krijuese (grupore) 15 pikë, Provimi me shkrim 50 pikë</i></p>				

VITI I DYTË – SEMSETRI III

Lënda: Fiziologjia e ushtrimeve dhe sportit				
Viti II	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester III/IV	Obligative	2	1	6
<u>Përmbajtja:</u> Lënda do të mbahet në formë të ligjeratave, ushtrimeve dhe seminareve.				
<u>Qëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Qëllimi kryesor i lëndës Fiziologjia e njeriut është të ofroj një prezentim në detaje të funksionit të organeve dhe sistemeve të organeve të trupit të njeriut. Kjo lëndë është e dizajnuar në atë mënyrë që studentët të kuptojnë funksionin e secilit organ dhe sistem të organeve, mekanizmat rregullues në trupin e njeriut dhe integrimin fiziologjik të sistemit të organeve në ruajtjen e homeostazës. Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të jetë në gjendje të sqarojnë: <ol style="list-style-type: none">1. Integrimin e sistemeve të organeve në mbajtjen e gjendjes stabile në ambientin e brendshëm2. Rregullimin e homeostazës përmes faktorëve nervor dhe endokrin3. Mënyrën se si sistemi kardiovaskular, sistemi limfatik, sistemi respirator, sistemi digjestiv, sistemi urinar dhe sistemi imunitar kontribuojnë në shpërndarjen e materieve dhe në ruajtjen e homeostazës4. Mënyrën se si sistemi nervor (qëndror, periferik dhe autonom), shqisat dhe sistemi endokrin kontribuojnë në funksionet rregullatore, komunikimin integruar dhe koordinimin e përgjithshëm të trupit të njeriut5. Mënyrën se si sistemi reprodiktiv kontribuon në reproduksion, rritje dhe zhvillim të trupit të njeriut.				
<u>Metodat e mesimdhënies dhe mesimnxënies:</u> Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.				
<u>Literatura:</u> <ol style="list-style-type: none">1. Vassillis Klissouras (2014). Bazat e fizilogjise se ushtrimeve dhe sportit. Night design studio. G2. Guyton & Hall - Medical Physiology Lauralee Sherwood -. Human Physiology				
<u>Forma e vleresimit:</u> <i>Vlerësimi ne pikë(%):Pjesmarrja në ligjërata 10 pikë, Prezantime seminarike 20 pikë, Testime të ndryshme me shkrim 5 pikë, Punime të ndryshme krijuese (grupore) 15 pikë, Provimi me shkrim 50 pikë</i>				

Lënda: Gjymnastikë sportive				
Viti II	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester III/IV	Obligative	2	2	6
<u>Përmbajtja e Lëndës:</u>				
<p>Lënda e Gjymnastikës jep një prezantim dhe përmbledhje rreth konceptit të gjymnastikës, njohurive thelbësore të lëndës teoriko-praktike, sfidave dhe përfitimeve të aplikimit të gjymnastikës në trupin e njeriut. Aplikimi i gjashtë disiplinave për meshkuj dhe katër disiplina të gjymnastikës për femra përmirëson shumë dhe drejtpërdrejt formën fizike si parakusht për plotësimin e kriterëve të mësimdhënies së edukimit fizik gjithashtu stimulon të menduarit dhe veprimin në kohë dhe hapësirë në boshte dhe rrafshet të ndryshme të lëvizjes. Qëllimi i lëndës së gjymnastikës është të aftësojë studentët me ushtrime lëvizore, të përdorin mjete gjymnastike si mjete të nevojshme në funksion të transformimit të statusit bio psiko-somatik, përkatësisht zhvillimit të psikomobilitetit ose funksionalizimit didaktik dhe arritjes së njohurive teorike.</p>				
<u>Qëllimi dhe rezultatet e pritura:</u>				
<p>Pas përfundimit të suksesshëm të kësaj lëndë studentët do të jenë në gjendje të:</p> <p>Njohuri:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të kuptojnë nocionet dhe konceptet bazë nga Gjymnastika. - Të identifikojnë ushtrime nga Gjymnastika dhe t'i përshkruaj ushtrimet saktë. - Të jenë në gjendje të demonstroj drejt elemente nga Gjymnastika. - Të planifikojnë dhe të udhëheq një proces stërvitor konform grupmoshave të ndryshme. <p>Shkathtësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jenë në gjendje të ndërlidhin njohuritë e fituara teorike dhe praktike për zhvillimin dhe zbatimin e programit të Gjymnastikës sipas grupmoshave të caktuara. - Të dëshmojnë aftësi për klasifikimin e ushtrimeve në Gjymnastikë dhe shpjegimin e ushtrimeve duke aplikuar edhe metodikën e të mësuarit. - Të demonstrojnë aftësi për përdorim të metodave dhe teknologjive të reja për të strukturuar dhe zbatuar një plan stërvitorë me elemente të Gjymnastikës me kategori dhe grupmosha të ndryshme. <p>Kompetenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jenë në gjendje të zbatojnë programe stërvitore të bazuar në nevojat e grupit specifik duke respektuar karakteristikat zhvillimore të grupit (kuptimi i karakteristikave antropometrike- lëvizore, psikologjike, sociale). - Të planifikojnë dhe zbatojnë ushtrime specifike (për forcë, lëvizshmëri, ekuilibër dhe koordinim) të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejt në realizimin e elementëve të Gjymnastikës. <p>Të jenë në gjendje të aplikojnë analiza statistikore themelore specifike dhe mjete ndihmëse të teknologjisë së informacionit me qëllim të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për t'i përdorur në procesin e planifikimit dhe përcaktimit të ngarkesave në stërvitje.</p>				
<u>Metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies:</u>				
<p>Ligjerata, mësimi praktik dhe ushtrime, punim seminarik dhe prezantim i punimit seminarik, punë individuale, detyra, grupe, etj.</p>				
<u>Literatura:</u>				
<ul style="list-style-type: none"> - Hraski, Ž., Ž. Pedišić & M. Vunić, (2004). Gimnastička anamneza studenata druge godine Kineziološkog fakulteta. In K. Delija (Ed.), Zbornik radova 13. ljetne škole kineziologa Republike Hrvatske «Vrednovanje u području edukacije, sporta i rekreacije», Rovinj 2004, pp. 317-323 - Mitchell, D., B. Davis & R. Lopez (2002). Teaching Fundamental Gymnastic Skills. Human Kinetics - Fadil Mahmuti, (2012) Gjymnastika mbi Vegla – Tekst Universitar - Neshet Koshi, (1984) Gjymnastika Sportive – Përkthim Tekst Universitar - Federation Internationale De Gymnastique https://www.gymnastics.sport/site/ - MAG CoP 2025-2028 https://www.gymnastics.sport/site/rules/#2 1. WAG COP 2025-2028 https://www.gymnastics.sport/site/rules/#3 				
<u>Forma e vlerësimit:</u>				
<p>Pjesëmarrja në ligjerata dhe përkushtimi - 20%, prezantimet - 10%, Vlerësimi 1 - 15%, praktika 40%, Vlerësimi 2 - 15%</p> <p>Ps: Mungesa e plotësimin të kriterëve minimale nënkupton vlerën zero (0) në vlerësimin e vazhdueshëm.</p>				

Lënda: Psikologjia e edukimit fizik dhe sportit				
Viti II	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester III	Obligative	2	0	5
<u>Përmbajtja:</u> Hyrje: Perkufizimi I lendes, raportet e saj me shkencat tjera, metodat dhe teknikat e psikologji se sportit, teorite e personalitetit, agresiviteti ne sport, stresi dhe sporti, frika dhe sporti, psikodinamika e grupit sportiv.				
<u>Oëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Psikologjia e edukimit fizik dhe sportit ka te beje me studimin e sjelljes se sportistit ne aktivitetet sportive dhe pergaditjen psikologjike per arritjen e rezultateve. Te njoftoje studentet sesa eshte e dobishme pergaditja psikologjike e sportistit. Fiton njohuri dhe aftesi ne pergaditjet psikologjike ne aktivitetet sportive, menjanimi i stresit para dhe gjate aktivitetit, metodat dhe teknikat educative dhe sportive.				
<u>Metodat e mesimdhënies dhe mesimnxënies:</u> Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.				
<u>Literatura:</u> 1. Mr.sc.Mahmut Germizaj, Psikologjia e Sportit 2. Weinberg, R.S. & Gould, D. (2011). <i>Foundations of Sport and Exercise Psychology</i> (5th ed.). Champaign, IL: Human Kinetics, 2013				
<u>Forma e vleresimit:</u> <i>Vlerësimi ne pikë(%): Pjesmarrja në ligjërrata 10 pikë, Prezantime seminarike 20 pikë, Testime të ndryshme me shkrim 5 pikë, Punime të ndryshme krijuese (grupore) 15 pikë, Provimi me shkrim 50 pikë</i>				

Lënda: Basketboll				
Viti II	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS 7
Semester III/IV	Obligative	2	2	6
<p><u>Përmbajtja:</u> Arrihet aftësi i studentëve si dhe proceset permanente e përvetësimi i tyre profesional e kërkimor, duke u bazuar në basketbollin më bashkëkohor në punën për paisjen dhe avancimin e studentëve. Studentët do të marrin njohuri themelore të përgjithshme, e të hartojnë planprograme bazike më relevante për basketbollin bashkëkohorë. Zhvillojnë aftësitë e tyre me format organizative të punës, dijnë t'i zgjedhin mjetet, metodat, dhe ngarkesat të cilat paraqiten gjatë seancave stërvitore sidomos ata të cilët orientohen në lëndën e basketbollit</p>				
<p><u>Oëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Është që studentët të jenë në gjendje që të të: të marrin informata mbi të arriturat më të reja teori praktike, si bazë e planifikimit, kontrollimit të proceseve stërvitore në kuadër të lëmisë së basketbollit. Nënkuptojnë njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë që do t'i fiton studenti pas përfundimit të sukses ligjëratave.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohuritë metodike të elementeve tekniko- taktike - Të hartojë dhe planifikojë materien e lëndës së basketbollit - Të udhëheqë dhe zhvillojë procesin e mësimin nga lënda e basketbollit - Të vlerësojë nivelin e të arriturave gjatë procesit të transformimit - Të planifikojë dhe programojë punën praktike profesionale - Të demonstrojë të gjitha elementet teknike të basketbollit - Të kenë njohuri përkatëse për rregullat mbi organizimin e seancave stërvitore dhe garave të niveleve të ndryshme. 				
<p><u>Metodat e mesimdhënie dhe mesimxënies:</u> Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.</p>				
<p><u>Literatura:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Basketboll - Tekst Mësimor Universitar – 2006. Prishtinë. 2. Basketball offenses and play. 1st The coach's guide. 2005 3. BaH.Salihu.: Basketboll – Tekst Mësimor Universitar – 2006. Prishtinë. 4. Q. Shalsi.: Stërvitja është shkencë, loja është art. Tiranë-2004. 5. Isi.;Q. Karaj.;G. Kavaja.:S. Kuvarati.: Basketboll Teknika dhe Taktika. Tiranë-1991 6. H,Salihu: Taktika në Basketboll. Tekst Mësimor. 2017. 				
<p><u>Forma e vlerësimit:</u> Forma e vlerësimit: Prezantime, seminare 20%; vijueshmëria 10%; Pjesëmarrje aktive 10%; provimi teorik 25% Provimi praktik 35%.</p>				

Lënda: Hyrje në Biomekanikë				
Viti II	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester III/IV	Obligative	2	1	6
<u>Përmbajtja:</u>				
Studimi bazik anatomiko- mekanik i aparatit lokomotor te njeriut me zbatimin e ligjshmërive mekanike gjate perfotmancave sportive.				
<u>Oëllimet dhe rezultatet e pritura:</u>				
Kuptimi i bazave të mekanikës së lëvizjeve të trupit të njeriut përmes teknikës sportive, simulimit të lëvizjeve të trupit të njeriut duke i përcjell madhësitë themelore mekanike me zbatimin e ligjeve te Biomekanikës.				
<ul style="list-style-type: none"> - te njehe mekaniken e elementeve themelor strukturale te sistemit lokomotor te njeriut, - te njehe ligjshmëritë biomekanike të vendosjes së lëvizjes së pjesëve të trupit dhe tërëtrupit të njeriut - te analizoj lëvizjet themelore të pjesëve të trupit dhe tërë trupit të njeriut, - te njehe ligjshmëritë e bazës së krijimit të lëvizjeve të ndërlikuara të aparatit lokomotor - të zbatojnë parimet biomekanike për të përmirësuar performancën dhe për të ulur rrezikun e lëndimeve. 				
<u>Metodat e mesimdhenies dhe mesimnxenies:</u>				
Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.				
<u>Literatura:</u>				
<ol style="list-style-type: none"> 1. Hyrje në Biomekanikë (ligjerata te autorizuara) (A.Dujaka 2015) 2. Biomekanikë me kinezilogji (2022) Sh. Rrecaj-Malaj, Dafinë Ibrahim-Kaçuri, Universiteti i Prishtinës 3. Lukman, L .(1989), Praktikum nga biomekanika (përkthim A. Dujaka) FKF,Prishtinë 4. Ballreich, R., Bauman, W. (1996), Grundlagen der Biomechanik sports, Enke, Stuttgart 5. Hall, S. J. (2018). Basic Biomechanics. McGraw-Hill. 6. McGinnis, P. M. (2013). Biomechanics of Sport and Exercise. Human Kinetics. 7. Hamill, J., Knutzen, K. M., & Derrick, T. R. (2015). Biomechanical Basis of Human Movement. Lippincott Williams & Wilkins. 				
<u>Forma e vleresimit:</u>				
<i>Vlerësimi ne pikë(%): Pjesmarrja në ligjërata 10 pikë, Prezantime seminarike 20 pikë, kolokfiumi me shkrim 20 pikë, Provimi me shkrim 50pikë</i>				

Lënda: Not				
Viti 2	Statusi	Ligjërata	Ushtrime praktike	ECTS
Semestri III dhe IV	E obliguar	2	2	6
<p><u>Përmbajtja:</u> Historia e notit dhe zhvillimi i teknikave të notit. Organizimi dhe rregullat e garave të notit. Klasifikimi i garave të notit. Bazat hidromekanike dhe hidrodinamike të pluskimit dhe notit. Analiza biomekanike, strukturore, kinematike dhe dinamike e teknikave të notit me starte dhe kthime. Analizë kineziologjike dhe antropologjike e teknikave të notit me starte dhe kthime. Efektet e notit në statusin antropologjik të notarëve. Rëndësia e karakteristikave antropologjike për suksesin në teknika dhe gara noti. Ndikimi i programit të notit në zhvillimin e karakteristikave antropologjike të fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve në procesin e mësimdhënies, rekreacionit dhe rehabilitimit. Bazat e metodave të mësimdhënies dhe stërvitjeve në not. Analiza e metodave në not - metodat e mësimimit të notit, kërcimit në ujë dhe zhytjes, teknikat e notit me starte dhe kthime. Pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të notojnë duke ekzekutuar një teknikë noti në gjatësi 100 m (4 gjatësi pishinës gjysmë olimpike) pa u ndalur. Aktivitetet përkatëse që janë pjesë e kursit të notit do të prezantohen edhe: Teknikat themelore të mbijetesës personale dhe shpëtimit të jetës, organizimi i ngjarjeve të notit - sporteve ujore.</p> <p><u>Objektivat dhe rezultatet e të nxënit:</u> Lënda not synon të zhvillojë kompetencë dhe teknikat në not. Nga pjesëmarrësit pritet që të praktikojnë, të përvetësojnë dhe së fundi, të demonstrojnë teknikë korrekte dhe efikase në të paktën tre nga katër teknikat e notit (krol, krol në shpinë, bretkosë dhe delfin). Në fund të modulit studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillojnë mësimin e notit për jonotarët në moshën parashkolllore, shkollore dhe të rritur; • Realizojnë aktivitetet e lidhura me kurrikulën në lidhje me përmirësimin e shkathtësive në not; • Analizojnë teknikat e notit dhe të aplikoi aktivitete për përmirësim të teknikave notuese; • Notojnë lirshëm deri në një nivel të pranueshëm qëndrueshmërie; • Ekzekutojnë me sukses të paktën tri (3) teknika notuese dhe të kuptojnë rregullat bazë të Federatës së Sporteve të Ujit për teknikat referente; • Pjesëmarrësit do të jenë gjithashtu në gjendje të ekzekutojnë Startet, Kthimet dhe Përfundimet në 4 teknikat; • Përvetësojnë njohuri bazë për sigurinë në ujë; • Mbijetesën personale dhe teknikat e shpëtimit – informata bazike; • Të jenë të informuar lidhur me aftësitë e shpëtimit: shpëtimin e jetës, tërheqje e viktimës potenciale, zhytje vertikale, rrëshqitje nën ujë, not me rroba/veshje trupi, hyrje dhe dalje të sigurta; • Marrin njohuri bazike për praktikën e sigurta dhe organizative e aktivitetëve të Ujit dhe Sporteve Ujore. <p><u>Metodologji e mësimdhënies:</u> Ligjërata teorike; Ligjërata Praktike; Punë në grupe; Diskutim; Ushtrime praktike etj.</p> <p><u>Literatura:</u> Ligjërata teorike; Noti, Dr. Mehdi Jashari, nentor 20001 Colwin, C. M. (1992). Swimming into the 21st century. Champaign, IL: Human Kinetics. Maglischo, E. W. (1993). Swimming even faster. Palo Alto, CA: Mayfield Publishing Company. YMCA (1999). The youth and adult aquatic program manual. Champaign, IL: Human Kinetics. Costill, D.L., E.W. Maglischo, A.B. Richardson (1992). Swimming. Backwell Scientific Publication. YMCA (1999). The youth and adult aquatic program manual. Champaign, IL: Human Kinetics American Red Cross. Swimming and Water Safety. The American National Red Cross. 2004.</p> <p><u>Forma e vlerësimit:</u> Vijueshmëria 20%; Punim seminari 10%; Vlerësim me shkrim (Kolokvium I dhe II) 15% dhe 15%; Vlerësim praktik 40% Vlerësimi pozitiv fitohet nëse në mënyrë kumulative grumbullohen së paku 51% e totalit të përgjithshëm. Në secilin instrument vlerësues që nuk arrihet PRAGU MINIMAL, kalueshmëria do të vlerësohet me zero (0) pikë.</p>				

Lënda: Rekreacion sportiv				
Viti II	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS 4
Semester III	Obligative	2	1	5
<p><u>Përmbajtja:</u> Lënda e rekreacionit përmban pjesën teorike të ligjeratave si dhe pjesën praktike e cila realizohet në sallën e fakultetit, në sallën e fitnesit dhe aerobisë si dhe përmes shetive të organizuara në natyrë të hapur si dhe në objekte hoteliere.</p>				
<p><u>Qëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Njoftimi i studentëve me kulturën rekreative dhe sportive si dhe vendin e tyre në kuadër të kulturës fizike. Qëllim tjetër i kësaj lënde është ofrimi i ndjenjes së kënaqësisë, zbavitjes, freskisë dhe forcimit të organizmit përmes aktiviteteve rekreative-sportive. Përmes metodave, detyrave dhe parimeve aktivitetet rekreativo sportive ndikojnë në rruajtjen e shëndetit të ushtruesve, rritjen e efektshmërisë punuese, pengimin e pleqërisë së parakohshme, rruajtjen e vitalitetit si dhe edukimin dhe arsimimin e personave që mirren me keto aktivitete. Pas vijimit të këtij moduli studenti: - fiton njohuri dhe shkathtësi si dhe aftësohet për organizimin e mësimit në salla fitesi, trim kabinete si dhe në kushte natyrore (përmes pikniqeve) -informohet dhe pasurohet me informata për përpilimin e planit dhe programit të punës duke pas parasysh programet rekreativo-sportive -njoftohet për përparsitë e të marrunit me ushtrime rekreative pa dallim moshe, gjinie apo nivelit të tyre punues si dhe -njoftohet për kujdesin që duhet patur gjatë përpilimit të programeve varsisht nga aftësitë e ushtruesve, mosha dhe gjinia e tyre.</p>				
<p><u>Metodat e mesimdhënies dhe mesimnxënies:</u> Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.</p>				
<p><u>Literatura:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ligjerata të autorizuara (B.Turjaka) Prishinë 2013 2. https://ourdaysoutside.com/20-surprising-outdoor-winter-activities/ 3. https://missrover.com/outdoor-winter-activities/ 4. https://rusticpathways.com/blog/summer-camp-activities 5. https://www.realsimple.com/work-life/entertainment/summer-activities 6. Grup autorësh (2002) Sportska rekreacija, Sarajevë 7. M. Andrijasevic (2000), Rekreacijom do zdravlja i ljepote, Zagreb 				
<p><u>Forma e vlerësimit:</u> <i>Vlerësimi në pikë(%): Pjesëmarrja në ligjërata 10 pikë, Prezantime seminarike 10 pikë, Testi parë 40 pikë, Tesi dytë 40 pikë</i></p>				

Lënda: Sociologji e edukimit fizik dhe sportit				
Viti II	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester III	Obligative	2	0	4
<p><u>Përmbajtja:</u> Kursi është koncipuar për të përfshi sa më shumë tematika nga jeta e organizuar shoqërore dhe sportive si dhe trendët aktuale të zhvillimit të cultures fizike dhe aktivitetëve sportive brenda dhe jashtë vendit. Tifozëria normale dhe e çmëndur si dhe dhuna e manifestuar në aktivitetet sportive , etj.</p>				
<p><u>Oëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Njohje me kategorite fundamentale te sociologjise dhe të sociologjisë së sportit; vënia në dukje e ndikimit interaktiv të fenomenëve të shoqërisë dhe fenomenëve të sportit. Të kuptuarit e dinamizimit të shoqërisë përmes sportit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të mësojnë e kuptojnë fenomenet sociologjike në krijimin dhe zhvillimin e sportit. - Të projektojnë dialektiken zhvillimore sport-shoqëri dhe shoqëri-sport. - Të zhvillojnë projekte studimore për t'u eksplikuuar strukturimi dhe funksionalizimi i shoqërisë. - Të kuptohen varëshmëritë dhe ligjësitë bio-somato-sociologjike dhe biopsiko-sociologjike: të kuptohet bio-sociogjeniteti i fenomenit të sportit dhe fenomeni i tërësisë sociabile. 				
<p><u>Metodat e mesimdhenies dhe mesimnxenies:</u> Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.</p>				
<p><u>Literatura:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fatos Gjata, Sociologjia e sportit, II. Tiranë, 2010 2. A. Anastasovski, Bazat e sociologjise se kultures fizike, Shkup, 1988. 				
<p><u>Forma e vleresimit:</u> <i>Vlerësimi ne pikë(%): Pjesmarrja në ligjërata 10 pikë, Prezantime seminarike 20 pikë, Testime të ndryshme me shkrim 5 pikë, Punime të ndryshme krijuese (grupore) 15 pikë, Provimi me shkrim 50 pikë</i></p>				

Lënda: Lojerat elementare				
Viti II	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS 4
Semester III	Zgjedhore	2	1	4
<u>Përmbajtja:</u> Klasifikimi i lojërave. Lojërat si pjesë integrale e jetës. Llojet dhe karakteristikat e lojërave elementare. Zgjedhja e lojërave për stinë të ndryshme të vitit. Zgjedhja e lojërave në formë të ndryshme organizative etj.				
<u>Qëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Kompetence për aplikimin e lojërave elementare për zhvillimin e aftësive dhe karakteristikave të ndryshme në fushën e edukimit fizik, sportit dhe rekreacionit.				
<u>Metodat e mesimdhënies dhe mesimnxënies:</u> Ligjerata, ushtrime, punë individuale, detyra, kolokfiume, punë grupore etj.				
<u>Literatura:</u> <ol style="list-style-type: none"> 1. Findak, V., V. Šnajder, (1987). Tjelesne aktivnosti djece i učenika na zimovanju. Zagreb: Školske novine. 2. Dale N. Le Fevre (2012). Best New Games. Human Kinetics 				
<u>Forma e vlerësimit:</u> <i>Vlerësimi në pikë(%): Pjesëmarrja në ligjërata 10 pikë, Prezantime seminarike 20 pikë, Testime të ndryshme me shkrim 5 pikë, Punime të ndryshme krijuese (grupore) 15 pikë, Provimi me shkrim 50 pikë</i>				

Lënda: Procesi stërvitor në Volejball				
Viti II	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester III	Zgjedhore	2	1	4
<u>Përmbajtja:</u> Kjo lëndë ka për qëllim që të paraqes metodat më të reja në fushën e trajningut në volejball, të bazuara në hulumtimet më të reja shkencore në këtë fushë pa dallim moshe dhe gjinie.				
<u>Oëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Pas përfundimit të kësaj lënde studenti do të jetë në gjendje që: <ul style="list-style-type: none"> - Të udhëheqë me procesin e të mësuarit me metoda cilësore të trajningut. - Të programojë procesin stërvitorë dhe të udhëheqë stërvitjen me grupmosha të reja. 				
<u>Metodat e mesimdhënie dhe mesimnxenie:</u> Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.				
<u>Literatura:</u> <ol style="list-style-type: none"> 1. Gjinolli .E volejball 2006 2. Shtjepani. S, Maqi. E dhe Gaxho. Teknika e lojës së volejbollit . 2005 3. Musa Selimi & Bahri Gjinovci, Enver Gjinolli (2014). Volejboli - Metodologjia e te mesuarit. Digiprint 				
<u>Forma e vleresimit:</u> Seminare 20%; vijim 10%; Pjesëmarrje aktive 10%; provimi teorik 25% Provimi praktik 35%. <u>Vlerësimi pozitiv fitohet me grumbullim kumulativ te pikëve (perqindjeve) ku minimum i nevojshëm është 51% i pikëve.</u>				

Lënda: Procesi stërvitor në Hendboll				
Viti II	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester III	Zgjedhore	2	1	4
<p><u>Përmbajtja:</u> Kjo lëndë ka për qëllim që të paraqes metodat më të reja në fushën e trajningut në hendboll, të bazuara në hulumtimet më të reja shkencore në këtë fushë pa dallim moshe dhe gjinie. Ky kurs poashtu do të ofrojë informacione rreth aspekteve teknike dhe taktike në lojën e hendbollit duke u bazuar në analiza laboratorike dhe informacione të mbledhura nga databazat e qasshme online. Të arrihet aftësimi i studentëve si dhe përvetësimi i tyre profesional e kërkimor, duke u bazuar në hendbollin më bashkëkohor. Studentët do të marrin njohuri themelore të përgjithshme, e të hartojnë planprograme bazike më relevante për hendbollin bashkëkohorë. Zhvillojnë aftësitë e tyre me format organizative të punës, dijnë t'i zgjedhin mjetet, metodat, dhe ngarkesat të cilat paraqiten gjatë seancave stërvitore, sidomos ata të cilët orientohen në lëndën e hendbollit.</p>				
<p><u>Oëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Është që studentët të jenë në gjendje që tëtë: të te marrin informata mbi të arriturat më të reja teorike dhe praktike, si bazë e planifikimit dhe kontrollimit të proceseve stërvitore në kuadër të lëmisë së hendbollit. Pas përfundimit të kësaj lënde studenti do të jetë në gjendje që: <ul style="list-style-type: none"> - Të udhëheqë me procesin e të mësuarit me metoda cilësore të trajningut. - Të programojë procesin stërvitorë dhe të udhëheqë stërvitjen me grupmosha të ndryshme - Të kuptojë sistemet e ndryshme në lojën e hendbollit, përparësitë dhe mangësitë e tyre - T'i kuptojë format stërvitore për përmirësimin e parametrave relevant për lojën e hendbollit. - Të vlerësojë nivelin e të arriturave gjatë procesit të transformimit - Të planifikojë dhe programojë punën praktike profesionale - Të demonstrojë të gjitha elementet teknike të hendbollit. - Të kenë njohuri përkatëse për rregullat mbi organizimin e seancave stërvitore dhe garave të niveleve të ndryshme. - Të jenë në gjendje të studiojnë literaturën </p>				
<p><u>Metodat e mesimdhënies dhe mesimnxënies:</u> Ligjërata praktike dhe teorike, punime profesionale, metodika e të mësuarit të elementeve tekniko-taktike seminare, diskutime, puna individuale, në grupe etj</p>				
<p><u>Literatura:</u> <ul style="list-style-type: none"> - Çitaku.F."Stërvitja sportive në hendboll" – Tekst Mësimor Univeuniversitar – 2009. Prishtinë - G.Kavaja.:J. Jarani; Hendboll (rregullat bazë). Tiranë-2004. - Zyber. K."Hendboll për mësuesit dhe treneret e hendbollit - Arthur Arthur .D. Hando (2021). Handball Playbook: Practical Handball Game Coach Play Book. <p>Gruić, I., Vuleta, D. (2008). Comparison of physical conditioning status of first and the male handball second league players. Carol Demand: HANDBALL 101, 2023.</p> </p>				
<p><u>Forma e vlerësimit:</u> Pjesëmarrja dhe angazhimi në mësim: 10% Puna praktike dhe seminarët 20 % Testet intermediere (semestrare dhe gjysmësemestrare) 30% Provimi final teorik dhe praktik 40% Rezultatet e vlerësimit përfundimtar 100%</p>				

Lënda: Menaxhimi i objekteve sportive				
Viti II	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester III	Zgjedhore	2	0	4
<u>Përmbajtia:</u> Kjo lende ka për qëllim zhvillimin e të kuptuarit të procedurave menaxhuese të cilat përdoren për menaxhimin e objekteve sportive dhe rekreative. Studentet do të fitojnë njohuri bazike në lidhje me qëllimet dhe objektivat primare të menaxhimit të objekteve; si të ndërtohet dhe financohet objekti; shfrytëzimi i objektit; administrimi dhe marketing; financat në lidhje me organizimin dhe menaxhimin e ngjarjeve dhe fusha të tjera me rëndësi.				
<u>Oëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Studentet, me përfundimin e kësaj lende do të kenë aftësi me të mëdha për të kuptuar se çka nevojitet për të zhvilluar dhe menaxhuar objektet sportive dhe rekreative si dhe për sfidat të cilat shfaqen gjatë procesit të menaxhimit të këtyre objekteve në praktikë.				
<u>Metodat e mesimdhënis dhe mesimnxënies:</u> Ligjerata, ushtrime, punë individuale, detyra, kolokfiume, punë grupore etj.				
<u>Literatura:</u> 1. Menaxhimi i Organizatave Sportive Olimpike 2007 2. Fried G (2010). Managing Sport Facilities (2 nd ed.). Human Kinetics. Champaign Il. 3. Westerbeek H, Smith A (2006). Managing Sport Facilities and Major Events. Routledge.				
<u>Forma e vlerësimit:</u> <i>Vlerësimi në pikë(%): Pjesëmarrja në ligjëratat 10 pikë, Prezantime seminarike 20 pikë, Testime të ndryshme me shkrim 5 pikë, Punime të ndryshme krijuese (grupore) 15 pikë, Provimi me shkrim 50 pikë</i>				

VITI I DYTË – SEMESTRI IV

Lënda: Histori e edukimit fizik dhe sportit				
Viti II	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS 4
Semester IV	Obligative	2	0	4
<u>Përmbajtia:</u> Lindja, zhvillimi, I aftësive fizike-motorike neper etapa te ndryshme nga paraklasikja deri te sporti modern Përshkruani lëndën.				
<u>Qëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Objektivi kryesor I kesaj lende eshte I orientuar kryesisht ne zhvillimin e aftësive levizore dhe funksionale te adaptuara neper periudha te ndryshme qe nga periudha e privitzmit, si dhe ku jan zhvilluar sportet individuale dhe kolektive.kur dhe ku jan mbajtur lojrat olimpike krijimi I fedaratave etj. Duhet të korrespondojnë me objektivat e Fakulteti përkatës. Pasi studenti ta perfundoj kete kurs ai duhet te jet ne gjendje ta dije si eshte zhvilluar levizja, cilat kan qen lojerat e para, disiplinat sportive si jan zhvilluar neper periusha te ndryshme. Te dije se prej nga e kan preardhjen disiplinat sportive. Si jan mbajt lojerat olimpike dhe si jan zhvilluar deri ne kohen moderne.				
<u>Metodat e mesimdhënies dhe mesimxënies:</u> Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.				
<u>Literatura:</u> 1. Historia e edukimit fizik dhe sportit dr.Bardhyl Misija Tirane 1997. 2. Swaddling, Judith, The ancient olympic games, university of texas press: 2 nd edition (2008).				
<u>Forma e vleresimit:</u> <i>Vlerësimi ne pikë(%):Pjesmarrja në ligjërata 10 pikë, Prezantime seminarike 20 pikë, Testime të ndryshme me shkrim 5 pikë, Punime të ndryshme krijuese (grupore) 15 pikë, Provimi me shkrim 50 pikë</i>				

Lënda: Shëndeti dhe Aktiviteti Fizik				
Viti II	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS 4
Semester IV	Obligative	2	0	4
<u>Përmbajtja:</u>				
<p>Përmbajtja e lëndës përfshin temat themelore të lidhura me konceptet bazë të shëndetit publik, mirëqenien psikofizike dhe ndikimin e aktivitetit fizik në sistemet fiziologjike të trupit. Theksohet rëndësia e parandalimit të sëmundjeve përmes aktivitetit fizik të rregullt, si dhe lidhja ndërmjet stilit të jetesës dhe shëndetit afatgjatë.</p> <p>Temat kryesore përfshijnë: Konceptet themelore të shëndetit dhe mirëqenies; Aktiviteti fizik dhe ndikimi në sistemin kardiovaskular, respirator, muskolor e skeletor; Aktiviteti fizik si faktor mbrojtës ndaj sëmundjeve kronike (obeziteti, hipertensioni, diabeti, sëmundjet kardiovaskulare); Roli i aktivitetit fizik në shëndetin mendor dhe reduktimin e stresit; Aktiviteti fizik në grupe të veçanta të popullsisë (fëmijë, adoleshentë, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara); Udhëzimet ndërkombëtare për aktivitetin fizik dhe shëndetin (p.sh. OBSH); Planifikimi dhe zhvillimi i programeve të aktivitetit fizik për shëndet publik dhe personal; Vlerësimi i gjendjes fizike dhe përcaktimi i objektivave shëndetësore.</p>				
<u>Oëllimet dhe rezultatet e pritura:</u>				
<p>Qëllimi i kësaj lënde është të zhvillojë te studentët njohuri të thelluara teorike dhe praktike për rolën e aktivitetit fizik në promovimin e shëndetit fizik dhe mendor. Studentët do të aftësohen të kuptojnë lidhjen ndërmjet aktivitetit fizik, stilit të jetesës dhe mirëqenies shëndetësore, si dhe të aplikojnë praktika të bazuara në evidencë për përmirësimin e shëndetit individual dhe të komunitetit. Lënda synon gjithashtu të zhvillojë kompetenca profesionale që lidhen me parandalimin e sëmundjeve jo-transmetuese, promovimin e zakoneve të shëndetshme dhe zhvillimin e programeve të përshtatura të aktivitetit fizik për grupe të ndryshme të popullsisë (fëmijë, të rritur dhe të moshuar).</p>				
<u>Rezultatet e pritura:</u>				
<ul style="list-style-type: none"> • Kuptojnë konceptet bazë të shëndetit dhe ndikimin e aktivitetit fizik në mirëqenie; • Shpjegojnë rolin e aktivitetit fizik në parandalimin e sëmundjeve jo-transmetuese; • Hartojnë dhe aplikojnë programe bazike të aktivitetit fizik për grupe të ndryshme të popullsisë; • Përdorin udhëzimet ndërkombëtare për promovimin e shëndetit në praktikë; • Ndërgjegjësojnë komunitetin për rëndësinë e aktivitetit fizik dhe stilit të jetesës së shëndetshme. 				
<u>Metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies:</u>				
<p>Ligjërata, diskutime në grup, mësimi i bazuar në raste, mësimi i bazuar në kërkim, klasa e kthyer (Flipped Classroom), të mësuarit përmes përvojës, mësimdhënia e simuluar.</p>				
<u>Literatura bazë</u>				
<ul style="list-style-type: none"> • Physical Activity and Health. (2019). 2nd ed. Human Kinetics. • Mišigoj-Duraković, M., & bashkëpunëtorët. (2018). <i>Ushtrimi fizik dhe shëndeti</i> (Botimi i dytë i plotësuar). Znanje d.o.o. • Exercise and Physical Activity for Health. (2020). Routledge. • World Health Organization. (2020). <i>Guidelines on physical activity and sedentary behaviour</i>. Geneva: WHO. https://www.who.int/publications/i/item/9789240015128 • Global status report on physical activity 2022 https://www.who.int/publications/i/item/9789240059153 				
<u>Literatura plotësuese:</u>				
<ul style="list-style-type: none"> • Bouchard, C., Blair, S. N., & Haskell, W. L. (2018). <i>Physical activity and health</i>. Human Kinetics. • Pescatello, L. S. (Ed.). (2021). <i>ACSM's guidelines for exercise testing and prescription</i> (11th ed.). American College of Sports Medicine. • Warburton, D. E. R., & Bredin, S. S. D. (2017). Health benefits of physical activity: a systematic review. <i>Current Opinion in Cardiology</i>, 32(5), 541–556. • World Health Organization. (2018). <i>Global action plan on physical activity 2018–2030: More active people for a healthier world</i>. WHO. 				
<u>Forma e vleresimit:</u>				
<p>Vijueshmëria e studentit dhe angazhimi gjatë ligjëratave - 20%; Detyrat individuale të kryera në klasë dhe shtëpi - 10%; Punimi seminarik - 10%; Vlerësimi semestral i parë - 30%; Vlerësimi semestral i dytë - 30%.</p>				

Lënda: Procesi stërvitor në atletikë				
Viti II	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester IV	Zgjedhore	2	1	4
<u>Përmbajtja:</u>				
<p>Programi i mësimor i lëndes se atletikes mbi bazën e një përvoje te gjate ne procesin mësimor me studentet e Fakulteti Kulturës Kulturës dhe Sportit. Pajisja e studentit me njohuri bazë mbi atletiken si sport, dhe mjet i edukimit fizik, si dhe me shprehive e dukura aplikative dhe metodike mbi organizmin dhe zhvillimin e ushtrimeve dhe skemave atletikore, sipas programit të karakterit atletikor te mbështetur mbi baza te shëndosha e metodike organizative, për te gjitha kategoritë e shkollave ne Kosovë.</p>				
<u>Oëllimet dhe rezultatet e pritura:</u>				
<p>Nënkuptojnë njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë që do ti fiton studenti pas përfundimit të suksesshëm të këtij kursi. Për ti paraqitur këto tw arritura pwrdozen foljet si: din, pwrshkruan, krahason, projektton, harton, zhvillon etj.</p> <p>Pas përfundimit‘ të këtij kursi (lënde) studenti do te jetë në gjendje që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohja me vlerat qe merr atletika,si sport baze ne drejtim te edukimit e formimit te mjaft cilësive fizike,aq te domosdoshme për te gjithë kategoritë . - Njohja me bazat teorike e metodike te teknikave ne llojet atletikore. - Pajisja e studenteve me shprehi lëvizore teknike e shprehi jetësore. - Kompletimi i studenteve me aftësi organizative për te drejtuar dhe zhvilluar me kompetence orët e mësimit atletikor ne shkolle. - Pajisja e studenteve me njohuri mbi organizimin, zhvillimin dhe drejtimin e garave atletikore etj. 				
<u>Metodat e mesimdhenies dhe mesimnxenies:</u>				
Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.				
<u>Literatura:</u>				
<p>ALTIS. (2019). <i>Coaching the Short Sprints</i>. SHBA. – (2013). <i>Sprinting: Training, Techniques and Improving Performance</i>. Mbretëria e Bashkuar. (2025). <i>Study on the Evaluation and Training Strategies of Middle-Distance Running</i>. (2024). <i>The Effect of Strength Training Methods on Middle-Distance and Long-Distance Runners' Athletic Performance</i>. (2024). <i>Pacing Strategies in Marathons: A Systematic Review</i>.</p>				
<u>Forma e vleresimit:</u>				
<p>Seminare 20%; vijim 10%; Pjesëmarrje aktive 10%; provimi teorik 25% Provimi praktik 35%. Vlerësimi pozitiv fitohet me grumbullim kumulativ te pikëve (perqindjeve) ku minimum i nevojshëm është 51% i pikëve.</p>				

Lënda: Fushim malor dhe bregdetar				
Viti II	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester IV	Zgjedhore	2	1	4
<u>Përmbajtja:</u> Lënda e fushimit malor dhe bregdetar përmban pjesën teorike të ligjeratave si dhe pjesën praktike e cila realizohet përmes shetive të organizuara në natyrë të hapur dhe bregdet si dhe në objekte hoteliere.				
<u>Oëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Arritja e njohurive dhe përvojave praktike për ekzistimin në kushtet natyrore, si dhe pranë sipërfaqeve ujore, Arritja e njohurive dhe përvojave në përvetësimin e hapësirave dhe pengesave natyrore, Organizimi i shetive, fushimeve dhe turneve sportive me planprogram të caktuar, Organizimi i shetive, fushimeve dhe turneve tipike shkollore. Organizimi i shetive bregdetare, fushimeve bregdetare dhe turneve tipike shkollore. Pas vijimit të këtij moduli studentifiton njohuri dhe shkathësi nga kjo lëmi: <ul style="list-style-type: none"> - do të aftësohet për organizimin e mësimit në kushte natyrore si dhe ambientimin në këto kushte. - do të jetë në gjendje të përpiloj programin e punës duke pasqyruar kushtet e ambientit të jashtëm për grupmosha të ndryshme - do të fiton njohuri dhe përvoja për zgjedhjen e lokacionit dhe terreneve malore për aktivitetet në natyrë. - do të fiton njohuri dhe përvoja për zgjedhjen e lokacionit dhe terreneve bregdetare për aktivitetet në natyrë. 				
<u>Metodat e mesimdhënieve dhe mesimnxënies:</u> Ligjerata, ushtrime, punë individuale, detyra, kolokfiume, punë grupore etj.				
<u>Literatura:</u> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dispense e perkthyer dhe e pershtatur nga profesori i landes 2. M. Jevdovic (1998), Osnovi alpinisticke tehnike, Sarajevo 3. N. Nurkovic, I. Hmjelovec, E. Kazazovic (2006), Boravak u prirodi, Mostar 				
<u>Forma e vlerësimit:</u> <u>Seminare 20%; vijim 10%; Pjesëmarrje aktive 10%; provimi teorik 25% Provimi praktik 35%.</u> <u>Vlerësimi pozitiv fitohet me grumbullim kumulativ të pikëve (përqindjeve) ku minimumi i nevojshëm është 51% i pikëve.</u>				

Lënda: Beach Volley				
Viti I/Semestri -II	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
	Zgjedhore	2	1	4
<u>Përmbajtja:</u>				
<p>Lënda ofron njohuri të avancuara në metodikën e të mësuarit dhe në procesin stërvitor të volejbollit në rërë, duke i orientuar studentët drejt zhvillimit të kompetencave profesionale dhe shkencore në këtë disiplinë sportive. Përmbajtja e lëndës përfshin studimin e elementeve teknike dhe taktike, veçorive të trajnimit në ambiente të hapura, si dhe zbatimin e rregullave zyrtare të beach volley-it</p> <p>Gjithashtu, lënda synon të pajisë studentët me njohuri për organizimin dhe menaxhimin e aktiviteteve sportive jashtëshkollore, garave universitare dhe aktiviteteve rekreative, duke i mundësuar atyre aplikimin praktik të koncepteve teorike në kontekstin e edukimit fizik</p>				
<u>Qëllimi dhe rezultatet e pritura:</u>				
<p>-Qëllimi i lëndës është të zhvillojë tek studentët kompetenca profesionale, metodike dhe shkencore në procesin e mësimdhënies dhe stërvitjes së volejbollit në rërë. Lënda synon përvetësimin e bazave didaktiko–metodike për zhvillimin e elementeve tekniko–taktike, planifikimin e stërvitjeve dhe menaxhimin e situatave mësimore në kushte të jashtme.</p> <p>Në kuadër të formimit profesional të studentëve, lënda synon gjithashtu të aftësojë ata për organizimin e seksioneve sportive, garave shkollore dhe ndërshkollore, si dhe aktiviteteve rekreative që promovojnë pjesëmarrjen aktive në sport. Përmes këtij procesi, studentët pritet të kuptojnë dhe të vlerësojnë ndikimin edukativ dhe shëndetësor të beach volley-it.</p> <p>Pas përfundimit me sukses të këtij moduli, studentët pritet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Zbatojnë njohuritë didaktiko–metodike në procesin e mësimdhënies dhe stërvitjes së volejbollit në rërë, -Aftësohen për mësimdhënie praktike të elementeve tekniko–taktike të lojës së Beach Volley-it në nivelet shkollore dhe recreative, -Planifikojnë, organizojnë dhe udhëheqin seksione sportive, gara shkollore, ndërshkollore dhe aktivitete rekreative në ambient të hapur, 				
<u>Metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies:</u>				
Metoda verbale, e demonstrimit , interactive ,te ushtruarit praktik.				
<u>Literatura:</u>				
<ul style="list-style-type: none"> - Karakteristikat dhe loja e volejbollit në rërë. Bahri Gjinovci -Libër i ushtrimeve të Volejbollit në rërë, V.Nikqi B.GjInovci - Rregullat Zyrtare të Volejbollit në Rërë 2021-2024 Publikuar nga FIVB në 2021 – -Beach Volleyball . Karch Kiraly, Byron Shewman -Beach volleyball drill –book, www.fivb.com matrialet per edukim www.cev.eu -OFFICIAL BEACH VOLLEYBALL RULES 2021-2024 (Approved by the 37th FIVB World Congress 202) 				
<u>Forma e vlerësimit:</u>				
Pjesëmarrja në ligjërata – 5%, testi i parë 20%, prezantimet- 10%, pjesa praktike 25% vlerësimi final teorik 40%				

<u>Lënda: Tenis</u>				
Viti II	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester IV	Zgjedhore	2	1	4
<u>Përmbajtja:</u>				
<p>Zhvillimi historik i tenisit; Llojet e raketave dhe të sipërfaqeve të fushës; Rregullat e lojës; Ndikimi i tenisit në statusin psikosomatik; Analiza biomekanike e elementeve themelore teknike (drajv, sllajs, volej, smash, shërbimi); Veprimet themelore taktike, loja nga vija bazë, dalja në rrjetë, loja shërbim volej); Veprimet e ndryshme metodike për përvetësimin e elementeve teknike.</p>				
<u>Oëllimet dhe rezultatet e pritura:</u>				
<p>Të njohë studentët me sportin e tenisit, të aftësojë studentët për kryerjen praktike të elementeve teknike të tenisit. Të aftësojë studentët për demonstrimin e ushtrimeve. Poashtu studentët do të aftësohen që njohuritë dhe shkathtësitë e fituara të jenë në gjendje t'i transmetojnë deri te nxënësit, përkatësisht të dinë metodologjinë e mësimin të elementeve të tenisit.</p> <p>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të kryejë ushtrimet themelore në mënyrë të pavarur; 2. Të demonstrojë elementet teknike dhe taktike të tenisit; 3. Që njohuritë dhe shkathtësitë e fituara t'i përcjellë te të tjerët. 4. Në mënyrë të pavarur do të dijë të organizojnë gara në formë të turneve individual dhe gara ekipore. 				
<u>Metodat e mesimdhënis dhe mesimnxenis:</u>				
<p>Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.</p> <p>Mësimi do të zhvillohet kryesisht përmes ligjëratave praktike, por do të mbahen edhe ligjërata teorike. Gjatë ligjëratave praktike elementet teknike do të shpjegohen nga mesimdhënësi dhe do të demonstrohen nga asistenti. Gjatë ligjëratave teorike do të punohet në mënyrë interaktive, ku studentët do të kenë mundësi të shprehin mendimin e tyre, të komentojnë, sugjerojnë dhe bëjnë pyetje.</p>				
<u>Literatura:</u>				
<ol style="list-style-type: none"> 1. Rive J., Williams S. Tennis Skills and Drills. Human Kinetics. Champaign 2012 2. Roetert P., Ellenbecker T. Complete Conditioning for Tennis. Human Kinetics. Champaign 2007 3. United States Tennis Federation. Coaching Tennis – Technical and Tactical Skills. Human Kinetics. Champaign 2009 4. Matsuzaki, Karol: Tennis Fundamentals, Human Kinetics, 2004. 5. PeterScholl: Tennis, Hachette, 1995, Paris. 6. Bahtiri, A.: Ligjërata të autorizuara, Prishtinë, 2007 7. David Foster Wallace, String Theory On Tennis, 2024 				
<u>Forma e vleresimit:</u>				
<i>Testimet e ndërmjetme</i>				35 %
<i>Vijueshmëria</i>				5 %
<i>Angazhim gjatë mësimi</i>				10 %
<i>Testiminë fund të semestrit</i>				50 %

VITI I TRETË – SEMESTRI V

Lënda: Mjekësi sportive				
Viti III	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester V/VI	Obligative	2	1	6
<p><u>Përmbajtja:</u> Kjo lëndë ka për qëllim të ofrojë njohuri teorike dhe praktike mbi mjekësinë sportive, duke theksuar rolin e parandalimit, rehabilitimit dhe promovimit të shëndetit tek sportistët dhe popullata e përgjithshme aktive fizikisht. Studentët do të njoftohen me aspektet biologjike, klinike, psikosociale, higjienike dhe ligjore të fushës së mjekësisë sportive, si dhe me metodologjitë e vlerësimit, diagnostikimit dhe menaxhimit të lëndimeve sportive. Gjithashtu, lënda trajton ushqyerjen tek sportistët, antidopingun, si dhe qasjen e personalizuar ndaj grupeve të ndryshme të sportistëve (fëmijë, femra, të moshuar).</p>				
<p><u>Oëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Qëllimi i lëndës “Mjekësi Sportive” është të pajisë studentët me njohuri themelore mbi parimet e mjekësisë sportive dhe higjienës, duke theksuar ndikimin e aktivitetit fizik në organizmin e njeriut, parandalimin dhe menaxhimin e lëndimeve, promovimin e shëndetit dhe zakoneve të shëndetshme, si dhe zhvillimin e aftësive praktike për mbështetje dhe kujdes shëndetësor të sportistëve dhe individëve aktivë fizikisht. Lënda synon të forcojë aftësitë e studentëve për të lidhur konceptet mjekësore me praktikën sportive dhe edukimin fizik, duke kontribuar në përgatitjen e tyre si profesionistë të aftë për të promovuar shëndetin dhe performancën në sport e aktivitet fizik. Pas përfundimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojnë konceptet bazë të mjekësisë sportive dhe higjienës tek sportistët. • Të kuptojnë ndikimin e aktivitetit fizik në shëndetin individual dhe publik. • Të identifikojnë dhe udhëzojnë për menaxhimin e drejtë të lëndimeve sportive të shpeshta. • Të njohin bazat ligjore, etike dhe të sigurisë në mbrojtjen e sportistëve. • Të aplikojnë konceptet e higjienës trupore, ushqimore dhe mjedisore në sport. • Të zhvillojnë aftësi për vlerësimin e sportistëve para pjesëmarrjes në sport. • Të kuptojnë rëndësinë e ushqyerjes së drejtë tek sportistët dhe parandalimin e dopingut në sport. • Të aplikojnë parimet e ndihmës së parë pas lëndimeve. • Të promovojnë jetesën aktive dhe zakonet e shëndetshme në popullatë. 				
<p><u>Metodat e mesimdhënies dhe mesimnxënies:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligjërata interaktive (me prezantime, diskutime dhe shembuj praktikë). • Ushtrime praktike (vlerësime funksionale, testime të thjeshta, simulime të ndihmës së parë, analiza të rasteve klinike). • Diskutime dhe punë në grup mbi raste studimore. • Punë individuale: përgatitje e prezantimeve të shkurtra mbi temat e përzgjedhura. 				
<p><u>Literatura:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Brukner, P., & Khan, K. (2017). Brukner & Khan’s Clinical Sports Medicine (5th ed.). McGraw-Hill. 2. Bahr, R., & Engebretsen, L. (2014). Sports Injury Prevention. Wiley Blackwell. 3. Maughan, R. J., Burke, L., & Coyle, E. (2013). Food, Nutrition and Sports Performance. Routledge. 4. McArdle, W. D., Katch, F. I., & Katch, V. L. (2015). Exercise Physiology: Nutrition, Energy, and Human Performance. Lippincott Williams & Wilkins. 5. WHO, IOC & WADA materiale online për shëndetin sportiv, higjienën dhe antidopingun. 				
<p><u>Forma e vlerësimit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrja aktive në ligjërata dhe ushtrime: 20% • Prezantime individuale: 20% • Kolloqfiumi I: 30% • Kolloqfiumi II: 30% • Provimi përfundimtar: 60% 				

Lënda: Futboll				
Viti III	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester V/VI	Obligative	2	2	6

Përmbajtja:

Futbolli ne kurrikulen e edukimit fizik nw shkolle, shkolle e mesme te larte, fakultet, futbollit si aktivitet rekreativ, futsal, futbollit garues, historia e futbollit ne Kosove dhe bote. Rregullat e futbollit, rregullat e futsal-it. Analizat kineziologjike te lojes se futbollit. Karakteristikat e lojtareve varesisht nga pozicioni i tyre ne fushe etj.

Oëllimet dhe rezultatet e pritura:

- Marrja bazike e informatave ne lidhje me futbollin, kuptimi i principeve dhe faktoreve te lidhur me performance e lojes se futbollit.
- Jane te afte te tregojne aftesi bazike te elementeve teknike dhe taktike dhe manovrave te ndryshme.
- Te kualifikuar per te punuar me futbollist te rinj dhe mosha te ndryshme.

Metodat e mesimdhenies dhe mesimnxenies:

Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.

Literatura:

1. Aleksic, V., Jankovic A. (2006): FOOTBALL - history, theory, methodology. SPE, Belgrade
2. Jankovic, A., Leontijević, b. (2007): PRACTICUM - T and M football. SPE, Belgrade

Forma e vleresimit:

Seminare 20%; vijim 10%; Pjesëmarrje aktive 10%; provimi teorik 25% Provimi praktik 35%. Vlerësimi pozitiv fitohet me grumbullim kumulativ te pikëve (perqindjeve) ku minimum i nevojshëm është 51% i pikëve.

Lënda: Vallëzim				
Viti III	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS 5
Semester V/VI	Obligative	2	2	6
<p><u>Përmbajtia:</u> Zhvillimi historik i vallëzimit dhe formave të tij; aplikimi i vlerave të vallëzimit – edukim, rekreacion sportiv, nivel elitari i sportit, sistematizimi i strukturave të vallëzimit (folklori, struktura sociale dhe moderne e sportit); analizat strukturore dhe biomekanike të lëvizjeve bazike në vallëzim; ndërveprimi në mes të vallëzimit dhe mënyrave për shprehje të muzikës (ritmi, tempo, tingulli, dinamika). Analiza strukturore dhe biomekanike e strukturave lëvizore dhe lëvizjeve fine me rekuizita të ndryshme (litar, rreth, top etj.) Rregullat e gjimnastikës ritmike. Implementimi i gjimnastikës në edukim, sport, rekreacion, kineziterapi.</p>				
<p><u>Oëllimet dhe rezultatet e pritura:</u> Studentwt do tw fitojnw njohuri nw konceptet kineziologjike tw vallwzimit i cili i pwrmbush nevojat sociale, biologjike por mbi tw gjitha emocionale tw shoqwrsw. Pas pwrfundimit tw kwsaj lwndw studentwt do tw jenw nw gjendje tw:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të demonstrojnë aftësi për të transmetuar lëvizje teorike dhe mbështetje praktike të tyre (forma themelore lëvizore dhe të elemente themelore të vallëzimit dhe teknikës), tek fëmijët nivelit të ulët dhe të lartë para-universitar. - Implementimin e programeve të vallëzimit dhe gjimnastikës ritmike në të gjitha nivelet e edukimit, duke punuar me grupe të gjinisë dhe moshave të ndryshme. 				
<p><u>Metodat e mesimdhënie dhe mesimnxenie:</u> Ligjerata, ushtrime, pune individuale, detyra, kolokfiume, pune grupore etj.</p>				
<p><u>Literatura:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Cerny-Minton, S. (1989). Choreography. Human Kinetics Publisher, Champaign 2. FIG Pravilnik za ocjenjivanje ritmičko-sportske gimnastike (2004) Federation International of Gymnastic. 3. Wolf-Cvitak, J. (2000). Ritmička gimnastika. (Course material), Fakultet za fizičku kulturu, Zagreb. 4. Wolf-Cvitak, J. (2004). Ritmička gimnastika. KuglerHess, R., Nichlas, I., Schwablowski, R., Wendt, H. (1981). Gymnastik ohne Handgeräte. Sportverlag, Berlin 5. Jastrjemskaia, N., Y. Titov (1998). Rhythmic Gymnastics. Champaign: Human Kinetics. 				
<p><u>Forma e vleresimit:</u> <u>Seminare 20%; vijim 10%; Pjesëmarrje aktive 10%; provimi teorik 25% Provimi praktik 35%.</u> <u>Vlerësimi pozitiv fitohet me grumbullim kumulativ te pikëve (perqindjeve) ku minimum i nevojshëm është 51% i pikëve.</u></p>				

Course: Gjinnastikë Ritmike				
Year III	Statusi	Ligjerata	Ushtrime	ECTS
Semester V	Obligative	2	2	6
<p><u>Përmbajtja:</u> Zhvillimi historik i gjinnastikës ritmike dhe format e saj; vlera e zbatimit të vallëzimit - edukimi, rekreacioni sportiv, sporti i nivelit të lartë; sistematizimi i strukturave të vallëzimit (folklor, strukturë moderne sociale dhe sportive); analiza strukturore dhe biomekanike e strukturave themelore të lëvizjes në vallëzim; Ndërveprimi midis vallëzimit dhe mjeteve të shprehjes së muzikës (ritmi, tempo, tingulli, dinamika); Rëndësia e dimensioneve motorike, morfologjike, funksionale dhe njohëse në procesin e trajnimit dhe realizimit të strukturave të vallëzimit; metodat e mësimdhënies në vallëzim; metodat dhe mjetet dhe zbatimi i tyre në procesin mësimor; procesi transformues i statusit antropologjik në lidhje me moshën, seksin dhe nivelin e vrasjeve të vallëzimit; parametrat e ngarkesës në vallëzim; përbërësit e procesit të transformimit. Analiza strukturore dhe biomekanike e strukturave të lëvizjes dhe artit të vogël të dorës (litar, rrathë, top, kllapa, fjongo). Rregullat e gjinnastikës ritmike. Zbatimi i gjinnastikës ritmike në arsim, sport, rekreacion, kinesiterapi. Metodat e mësimin të elementeve të trupit në gjinnastikën ritmike (ecja, vrapimi, hapat specifike të vallëzimit, luhatjet, rrathët, valët, figura e tetë, kërcimet, kërcimet, kthesat dhe piruetat, ekuilibrat dhe elementët akrobatikë). Metodat e mësimdhënies së elementeve të ekzekutuara nga të gjitha artistikat e vogla të dorës (litar, hoop, top, kllapa dhe fjongo) dhe zbatimi i tyre në edukimin fizik. Bazat e koreografisë së ushtrimeve individuale dhe në grupe.</p>				
